

VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR. 10(447)

TETOR 2025

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI & BASHKIM HISARI ; website: www.VETERANIOBVL.ORG

ANALIZË

SHKRIMI DHE VLERËSIMI OBJEKTIV I LANÇ, MISION I ÇDO VETERANI E PASARDHËSI



Tefta CAMI

FAQE 2

82-VJETORI

KUR BRIGADA E 3-TË QËLLOI ME TOPASAMBLËNË TRADHTARE



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

FAQE 8

PROFILI

PROFESOR DR. HASAN ÇIPURI TERMINOLOGU I SHQUAR USHTARAK



Nga Prof. Dr. Hajri SHEHU

FAQE 12

Përkujtimi i 83-vjetorit të Konferencës së Pezës. Homazhe dhe vendosje kurore në emër të OBVLP

TATJANA ÇARKAXHIU (PARLLAKU) NË TRIBUNËN E TAKIMIT PËRKUJTIMOR NË 83 VJETORIN E KONFERENCËS SË PEZËS

ANALIZË

KEMI HARRU ME QESHË!

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Në mbarim të takimit përkujtimor me rastin e 83 vjetorit të Konferencës së Pezës, vizita në kompleksin bujqësor e blegtoral, në Pezë të Madhe qe vërtetë mbresëlënëse.

Në atë parajsë përrallore, brenda 5-6 hektarëve, me stalla moderne lopësh e pulash, me foragjere e pemëtore, gjithkush do të ndjehej i magjepsur. Gjithshka e ideuar dhe realizuar sipas vizionit e arkitekturës së sipërmarrësit të suksesshëm Kadri Cani, që nga porta hyrëse, dy godinat e pusi 88 metra i thellë (nga i cili, siç pohon ai, ka furnizuar edhe dhjetra shtëpi pezakësh që vuajnë mungesën e ujit).

Deri këtu, duket se gjithshka shkon si në vaj.

Por thellë në qënien e Kadri Canit dallon shqetësimin e të vetmuarit. Dhe ai nuk e fsheh këtë shqetësim. Ndërsa ulemi para njëres godinë për të shijuar rrushin, kumbullat e mollët e sapovjelura dhe rakinë e sapozjerë, Kadriu s'ndjehet aspak i qetë.

“Kemi harru me qeshë”, na thotë në një moment. Dhe vijon: Sot m'u largua pa e nisur punën edhe i vetmi punëtor që munda të gjeja, duke i premtuar se do ta paguaja me 5 mijë lekë të reja dita si dhe siguracion ligjor. Dhe s'qe ndonjë punë e rëndë, i thashë të më ndihmonte të ziejë rakinë nga rrushi i sapo vjelur.

Para disa ditësh mora edhe dy të huaj, (më duket se ishin bangladeshas), por edhe ata u larguan se nuk e përbaltonin punën... E kështu, i vetëm e kam tejet të vështirë të zhvilloj më tej këtë kompleks të ndërtuar me mund e djerse... dhe duke ja paguar shtetit të gjitha detyrimet një e më një....

Sa i trishtë ky realitet kur edhe një sipërmarrësi si ky i ka ngrirë buzëqeshja!

VIJON NE FAQEN 16



• Në emër të Organizatës së Bashkuar të Vetëranëve të LANÇ dhe pasardhësve, kryetarja e kësaj organizate Tatjana Çarkaxhiu Parllaku dhe anëtarja e Kryesisë së OBVLP, veterani 91-vjeçar Shuaip Methasani vendosën një kurorë me lule pranë memorialit të Konferencës në Pezë, në shenjë respekti dhe nderimi për të gjithë ata që kontribuuan në këtë moment historik për vendin...

FAQE 3


81-VJETORI/ Rruga e lavdishme e Brigadave të 9-të dhe 24 S partizane

FAQE 4

ANALIZË

ABSURDI I PASKVILEVE TË KAPLLAN RESULIT PËR KADARENË

Rreth librit “Shpifjet e Kadaresë nuk e ndryshojnë të vërtetën”



SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 14-15

DOSSIER

MEHMET HYSANI BASHKËLUFTËTAR ME MAHMUT DAC KALISIN

NGA SAKIP CAMI FAQE 6-7

PORTRET

MALIQ SADUSHI GJENERALI I MENÇURISË LABE

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

FAQE 10 - 11

81-VJETORI I RËNIES

DËSHMORI I ATDHEUT ARIF MARKJA, KRENARI E FAMILJES DHE E FISIT

Nga Skënder MURRJA

FAQE 9

IN MEMORIAM

38 VJET PA DËSHMORIN E AVIACIONIT NDUE LOGU

Nga Gjin MUSA

FAQE 5

ANALIZË

SHKRIMI DHE VLERËSIMI OBJEKTIV I LANÇ, MISIONI I ÇDO VETERANI E PËR PASARDHËSIT E VETERANËVE



Tefta CAMI*

Lexova shkrimin për Brigadën e XVIII-të Sulmuese, që përveç partive të djathta edhe përfshijë historian e mohojnë apo e etiketojnë ndryshe, që pushtuesit nazifashistë i vlerësojnë si kalimtarë dhe që kishin ardhur për t'na sjellë kulturë.

Ç'ironi!!! Për t'na sjellë "kulturë", apo si kalimtarë me armë e të armatosur, me tanke e avionë, që bombardonin, ku u vranë si luftëtarë dëshmorë gjatë LANÇ-re 28 mijë djem e vajza, duke flijuar jetën për çlirimin e mëmëdheut. Dibranët si të gjithë shqiptarët, u armatosën që ditën e parë me 7 prill 1939 të sulmit të forcave pushtuese fashiste italiane dhe shkuan deri në shkallën e Tujanit për të luftuar sipas traditës të organizimit të Maleve kundër forcave pushtuese. Por u informuan, se ishte pushtuar Tirana e ishte krijuar qeveria kolaboracioniste dhe u kthyen prapë për të mbrojtur familjet e krahinat e tyre.

Shqipëria që i pari vend në Ballkan, që u përfshi në Luftën e Dytë Botërore që me 7-të prill 1939. U krijuan çeta fshati e krahine, siç qe krijuar çeta antifashiste e Malit të Gollobordës që në janar 1940 nga Ahmet Cami si komandant dhe Uke Dan Cami-zv/komandant, që ishte kryetar i Malit të Gollobordës.

Ndërsa Britania e Madhe për të nxitur organizimin e luftës në vendet e Ballkanit krijoi në Beograd Qendrën e Inteligjencë Servisit me degë për të gjitha vendet e Ballkanit, si dhe për Shqipërinë me drejtues Gjergj Kokoshin.

Duhet shkruar realisht LANÇ-re sipas dokumenteve arkivore të AQSH e kujtimeve të veteranëve dhe dokumenteve të të huajve dhe të evitohen e pastrohen nga subjektivizmat e glorifikimet e padrejta, nga mohimet e degradimet dhe përvetësim të luftës së dëshmorëve, siç kanë bërë disa veteranë të Dibrës, që banonin në Tiranë ndaj luftës e sakrificave të dëshmorit Ahmet Cami. (AQSH, fondi i KQ të PPSH).

RRUGA E LAVDISHME E BRIGADËS XVIII SULMUESE

Brigada e XVIII-të Sulmuese është krijuar me 18 gusht 1944 në fshatin Sllatinë të Slllovës e të Qarkut të Dibrës me komandant Petrit Dume e komisar Esat Ndreun. Kjo Brigadë është krijuar nga Batalioni i Dibrës, i Martaneshit dhe Çermenikës, si dhe patriotët të tjerë nga Dibra.

Luftimet e para kjo Brigadë së bashku me Brigadën e V-të Sulmuese i ka bërë në malin e Korabit kundër forcave pushtuese naziste gjermane e bashkëpunëtorëve të tyre.

Me 2 shtator 1944 Brigada e XVIII-të dhe Brigada e V-të çliruan qytetin e Dibrës së Madhe.

Me 21 shtator 1944 forcat e Brigadës të XVII-të dhe të Brigadës të XVIII-të goditën forcat kundërshtarë të rajonit të fortifikuar të Kalasë së Dodës, Lumë.

Me 5 nëntor filloi goditja kundër nazistëve në Kukës. Brigada e XVIII-të Sulmuese ka luftuar gjatë rrugës së tërheqjes së forcave pushtuese naziste gjermane: Prizren-Kukës-Pukë. Kjo Brigadë mori pjesë në çlirimin e Prizrenit me 16-të nëntor 1944-ër bashkë me Brigadën e V-të Sulmuese.

Me 17-të nëntor 1944 ka goditur kolonën kundërshtarë, që vinte nga Prizreni për në Kukës.

Me 18-të nëntor 1944 ka çliruar qytetin e Kukësit.

- *Historia e LANÇ duhet shkruar realisht sipas dokumenteve arkivore të AQSH e kujtimeve të veteranëve dhe dokumenteve të të huajve dhe të evitohen e pastrohet nga subjektivizmat e glorifikimet e padrejta, nga mohimet e degradimet dhe përvetësim të luftës së dëshmorëve, siç kanë bërë disa veteranë të Dibrës, që banonin në Tiranë ndaj luftës e sakrificave të dëshmorit Ahmet Cami. (AQSH, fondi i KQ të PPSH).*



Është e njohur që shumë Brigada Shqiptare si Brigadat e V-të, VII-të, VIII-të, XVII-të, XVIII-të dhe më vonë Divizioni i III-të sipas Urdhërit të Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, Enver Hoxha, kaluan kufirin lindor, për të ndihmuar në çlirimin e territoreve shqiptare në Kosovë, Maqedoni, Preshevë e Nish. Sipas urdhërit të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-re Brigada e XVIII Sulmuese është nisur për në Kosovë dhe me 12-të mars 1945-së ka arritur në Mitrovicë. Ka qëndruar në territorin e Kosovës deri me 30-të qershor 1945-së.

QËNDRIMET E PADREJTA TË NDËRKOMBËTARËVE PËR LANÇ TË SHQIPËRISË

Brigadat shqiptare kanë marrë pjesë në Ofensivën e Madhe të dimrit 1944-1945 kundër forcave gjermane në koridorin e Nishit, si një nga pikat strategjike të frontit Ballkanik.

Ka pas partizanë të kësaj Brigade, që kanë treguar, se kanë marrë pjesë në çlirimin e Luginës së Preshevës, Bujanovcit e Medvegjës dhe në çlirimin e Sanxhakut të Nishit deri tek Molla e Kuqe (Pika Doganore midis Shqipërisë e Serbisë). Gjatë qëndrimit në Kosovë e viset e tjera shqiptare, partizanët janë njohur me ndienjat e urrejtjes të serbëve ndaj shqiptarëve, si dhe ndienjat e mosbesimit të shqiptarëve ndaj parullës së njohur të "bashkim vëllazërim" me popujt sllavë, sidomos me serbët. Banorët shqiptarë kujtonin genocidin e hershëm e të përherëshëm, dhunën e terrorin, vrasjet e djegiet, shpërnguljet me dhunë, si dhe grabitjen e pronave të shqiptarëve. Këto ndienjat e mosbesimit ndaj serbëve të shqiptarëve, i kanë etiketuar si të padrejta e nacionaliste, që ndikonin në prishjen e marrëdhënies të bashkim vëllazërimit të shqiptarëve me serbët. Prandaj janë mbajtur qëndrime të padrejta e ndëshkuese nga forcat tona partizane ndaj këtyre shqiptarëve patriotë.

Territoret e sipërpërmendura në ato vite banoheshin mbi 90-të përqind me popullsi shqiptare, por është ushtruar një genocid i tmerrshëm mbi popullsinë shqiptare dhe janë çpopulluar ato territore shqiptare sipas projektit të Vasa Çubrilloviçit, si dhe janë vendosur popullsi serbe e malazeze, si dhe shqiptarët e mbetur i kanë asimiluar.

Gjatë luftimeve për çlirimin e trojeve shqiptare, pra të Shqipërisë përtej kufirit nga forcat pushtuese naziste janë vrarë mjaftë djem e vajza të Shqipërisë, që u tërhoqën eshtrat e tyre pas viteve '70-të dhe u vendosën në varrezat e Dëshnorëve.

Gjatë viteve 1942-1944 Tito me bashkëpunëtorët e tij patën premtuar, se çeshtja e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë do të vendoset sipas dëshirës së shqiptarëve të të drejtës për vetvendosje, sipas Kartës së Atlantikut e vitit 1941 të firmosur nga Roosevelt e Churchill. Por Shqipëria e trevat shqiptare nuk përmenden

konkretisht. Në Konferencën e Jaltës në shkurt 1945 Shqipëria nuk përmendet fare si një nga vendet e popujt, që kishin luftuar kundër forcave pushtuese nazifashiste deri në çlirimin e plotë të vendit me 29-të nëntor 1944-ër. Shqipëria nuk u njoh menjëherë si palë fituese dhe as nuk qe pjesëmarrëse në ndarjen e territoreve pas luftës.

Stalini, Roosevelt dhe Churchill nuk e përmendin Shqipërinë në diskutimet kryesore. Kështu që çeshtja e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare përtej kufirit mbetën në favor të federatës jugosllave.

Me fjalimin e Kryeministrit të Shqipërisë, Enver Hoxha në Konferencën e Paqes në Paris në vitin 1946 Shqipëria u njoh si palë ndërlyftuese kundër pushtuesve nazifashistë dhe për dëmet e luftës.

* * *

Në fund të fjalës time për krijimin e Brigadës së XVIII-të Sulmuese e ditën e çlirimit të Dibrës me 23 gusht 1944, dhashë mesazhin e patriotit të madh, Ali Ahmeti, që krijoi UÇK-n në Maqedoni e udhëhoqi Luftën dhe e mundi ushtrinë e shtetit maqedonas, që e detyroi Europën e qeverinë maqedonase të nënshkruhej Marrëveshja e Ohrit për të drejtën e mbajtjes të Flamurit kombëtar e të gjuhës shqipe, si dhe për liritë e të drejtat e tjera të shqiptarëve në Maqedoni.

Mesazhi i tij ishte:

"Me 14-të shtator të këtij viti zhvillohet protesta e madhe e organizuar nga Veteranët e UÇK-ës e Shoqata të tjera të Kosovës para Gjykatës së Hagës për lirim e drejtuesve të UÇK-ës me Hashim Thaçin në krye, që po mbahen prej 5-së viteve në paraburgim padrejtësisht". Do të ishte në nderin e detyrën e gjithë shqiptarëve, si dhe të ne dibranëve të merrnim pjesë në atë protestë patriotike kombëtare!

*Ish Ministre e Arsimit dhe Kulturës

SPECIALE

Përkujtimi i 83-vjetorit të Konferencës së Pezës. Homazhe dhe vendosje kurore në emër të OBVL

TATJANA ÇARKAXHIU (PARLLAKU) NË TRIBUNËN E TAKIMIT PËRKUJTIMOR NË 83 VJETORIN E KONFERENCËS SË PEZËS

- Në emër të Organizatës së Bashkuar të Vetëeraneve të LANÇ dhe pasardhësve, kryetarja e kësaj organizate Tatjana Çarkaxhiu Parllaku dhe anëtari i Kryesisë së OBVL, veterani 91-vjeçar Shuaip Methasani vendosën një kurorë me lule pranë memorialit të Konferencës në Pezë, në shenjë respekti dhe nderimi për të gjithë ata që kontribuan në këtë moment historik për vendin...
- Pas ceremonisë, vizitë impresionuese në fermën bujqësore e blegtorale të sipërmarrësit të suksesshëm Kadri Cani, në Pezë të Madhe

Në kuadër të festimeve për 83-vjetorin e Konferencës së Pezës, u zhvillua një aktivitet përkujtimor për të nderuar figurat dhe kontributin historik të pjesëmarrësve në këtë ngjarje kyçe të rezistencës antifashiste shqiptare.

Në ceremoninë përkujtimore në Pezë morën pjesë deputetë, përfaqësues të autoriteteve vendore, institucioneve shtetërore, organizatave të veteranëve dhe qytetarë të shumtë.

Në emër të Organizatës së Bashkuar të Vetëeraneve të LANÇ dhe pasardhësve, kryetarja e kësaj organizate Tatjana Çarkaxhiu Parllaku dhe anëtari i Kryesisë së OBVL, veteran 91-vjeçar Shuaip Methasani vendosën një kurorë me lule pranë memorialit të Konferencës në Pezë, në shenjë respekti dhe nderimi për të gjithë ata që kontribuan në këtë moment historik për vendin. Nga OBVL merrnin pjesë gjithashtu sekretari i përgjithshëm Halil Rama – Mjeshër i Madh dhe anëtari i kryesisë së kësaj organizate, mësuesi veteran Skënder Murrja.

Kryetarja e OBVL Tatjana Parllaku Çarkaxhiu që ishte në tribunën e këtij eventi përkarh Prof. Hulusi Hako-Kryetar i OVP të LANÇ “Nderi i Kombit”, bashkë me autoritete qendrore e lokale tha se në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të forcave antifashiste shqiptare, me synim që të formohet një front i përbashkët lufte kundër okupatorit. Pprotagonistë të këtij kuvendi që ishin 17 delegatë, përfaqësues të krahinave dhe besimeve të ndryshme fetare, klasave dhe shtresave me bindje politike nga më të

ndryshmet.

Pas fjalës programore të prof. Hakos, Znj. Çarkaxhiu - Parllaku bëri të ditur pjesëmarrësit e këtij kuvendi që vinin nga rryma të ndryshme politike, si: Abaz Kupi, Ymer Dishnica, Mustafa Gjinishi, Koço Tashko, Enver Hoxha, Nako Spiru Aziz Çami, Halim Begeja, Haxhi Lleshi, Ismail Petrela, Mustafa Xhani, Myslim Peza, Ndoc Çoba, Ramazan Jarani, Skënder Jegeni, Skënder Muço dhe Nexhmije Xhuglini.

83 vite pas Konferencës së Pezës, kryetarja e Këshillit Bashkiak të Tiranës, Megi Fino kujtoi sakrificat e bëra në vitin 1942 dhe theksoi rëndësinë e unitetit kombëtar.

Gjatë aktivitetit përkujtues, Fino deklaroi se detyrë sot është të vazhdohet me të njëjtën frymë si në Konferencën e Pezës.

“Detyra jonë si pasardhës e atyre që bënë aktin historik të Pezës është të tregojmë të njëjtin guxim e vizion sot në ditët tona të bashkojmë forca për të përmirësuar jetën e qytetarëve për të nderuar shkolla, institucione moderne për të respektuar të moshuarit për të mbështetur të rinjtë dhe për të afruar Shqipërinë çdo ditë e më shumë me Europën. Le të kujtojmë gjithmonë se Peza nuk ishte vetëm mbledhje politike, por një amanet i madh kombëtar të punojmë së bashku me zemër e mendje të hapur për një Shqipëri të lirë, të drejtë dhe europiane”, u shpreh Megi Fino, kryetare e Këshillit Bashkiak të Tiranës.

NJË NGA MOMENTET MË TË RËNDËSISHME TË UNITETIT POLITIK NË HISTORINË SHQIPTARE

Konferenca e Pezës, e mbajtur më 16 shtator 1942, shënon një nga momentet më të rëndësishme të unitetit politik në historinë shqiptare, ku përfaqësues të forcave të ndryshme politike u bashkuan për të krijuar një platformë të përbashkët në luftën kundër pushtuesve fashistë.

Disa prej vendimeve më të rëndësishme të konferencës së Pezës janë:

1- Krijimin e Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, ku do të bënin pjesë antifashistë pa dallim feje, krahine dhe ideje;

2- Mobilizimin e popullit në luftë kundër pushtuesve fashistë;

3- Ngritjen e Këshillave Nacionalçlirimtarë në të

gjithë vendin;

4- Rreshtimin e Shqipërisë përkrah koalicionit antifashist anglo-sovjeto-amerikan;

5- Krijimin e një Shqipërie të lirë, të pavarur e demokratike pas lufte.

Sa për çështjen e rikthimit të mbretit Zog u vendos që vendimi të merrej pas lufte nga vetë populli shqiptar. Lidhur me çështjen e Kosovës, u arrit në përfundimin që ajo të zgjidhej pas luftës, mbështetur në të drejtën e vetëvendosjes. Në fund të punimeve Konferenca zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar, me kryetar Kamber Qafëmallën.

Si çdo vit edhe këtë 16 shtator, u zhvilluan aktivitete në përkujtim të kësaj dite të rëndësishme historike për vendin tonë. Veprimtaria përkujtimore dhe festive që u organizua nga Bashkia Tiranë me rastin e 83-vjetorit të Konferencës së Pezës, nisi në orën 09:00 me ceremoninë zyrtare përkujtimore në memorialin e Pezës, në nderim të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Programi vijoi gjatë gjithë ditës deri në mbrëmje me lojëra tradicionale, valle popullore, koncerte, shfaqje teatrale dhe aktivitete të shumta kulturore e artistike.

VIZITË MBRESËLËNËSE NË FERMËN E SIPËRMARRËSIT SHEMBULLOR KADRI CANI

Pas veprimtarisë përkujtimore festive me rastin e 83-vjetorit të Konferencës së Pezës, drejtuesit e OBVL, kryetarja Tatjana Çarkaxhiu Parllaku, Sekretari i përgjithshëm Halil Rama dhe anëtarët e kryesisë Shuaip Methasani e Skënder Murrja vizituan fermën e sipërmarrësit të suksesshëm Kadri Cani – një kompleks mbresëlënës blegtoral në Pezën e Madhe, (2013 e në vazhdim), me 15 lopë, 10 viç, një dem e 2000 pula, si dhe me 1.2 ha në pronësi dhe 3 ha me qira, të mbjella me foragjere e perime, si dhe me pemë frutore të të gjitha llojeve.

Nga bashkëbisedimi me të krijuam bindjen se ai është përfaqësues i vlerave më të çmuara intelektuale të brezit të tij, me një integritet shumë të lartë moral dhe intelektual. Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin KRENARI. Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet...E pikërisht në këtë shtrat ka ecur dhe ecën Kadri Cani, i përshtatur mirë me kohën, bujar, fisnik, intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që ka çarë në jetë me mençuri e sakrificë.

HISTORIA

Kronikë e veprimeve luftarake të Brigadës që veproi në zonën e Ersekës, Korçës dhe Bilishtit

81 vjet më parë u përrua Brigada e 9-të Sulmuese

Më 16 Tetor 1944, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, të gjitha batalionet territoriale që vepronin në Qarkun e Korçës - "Fuat Babani", "Reshit Çollaku", "Skënder Çaçi", "Tomorri" dhe "Hakmarrja" - u inkuadruan në Brigadën e 9-të Sulmuese. Inagurimi i kësaj brigade u bë në katundin Lozhan.

Qysh në fillim brigada kishte një efektiv prej 1500 partizanësh dhe ish e plotësuar me kuadro, armë e municione. Edhe eksperiencia luftarake nuk u mungonte partizanëve dhe kuadrove të saj, sepse ata ishin luftëtarë trima dhe të vendosur të atyre batalioneve që kishin pasuruar traditat e tyre në shumë luftime kundër pushtuesit dhe tradhëtarëve të vendit.

Si zonë veprimi, Brigada e 9-të kishte Ersekën, Korçën dhe Bilishtin. Batalionet e saj më 19 Tetor 1944 muarën në dorëzim sektorët dhe filluan menjëherë nga veprimet luftarake. Me 21 tetor goditën autokolonat gjermane në Qarr, përqëndrimet e tyre në Dvoran, postabllokun e qytetit të Korçës nga ana e Pogradecit, etj., duke i shkaktuar armikut dëme të mëdha.

Më 22 Tetor '44 forcat e batalionit të parë përsëritën goditjet e tyre kundër postabllokut nga ana e Pogradecit.

Më 23 Tetor batalioni i parë arriti pranë shtabit operativ, që ishte formuar për të drejtuar luftimet për çlirimin e Korçës, për t'u vënë në dispozicion të tij. Sipas detyrës, batalioni i dytë sulmoi qytetin nga ana e Ravonikut (nga postblloku i rrugës Boboshticë deri në atë të Turanit). Batalioni i tretë vazhdoi rrugën për të



arritur objektivin që i ishte caktuar nga komanda e Brigadës.

Më 24 Tetor '44 forcat e batalionit të 4-të të Brigadës së 9-të S prenë rrugën Korçë-Bilisht te Gryka e Cangonjit dhe sulmuan forcat armike që ndodheshin në qytet nga ana e Dishnicës. Batalioni i 2-të filloi goditjet kundër postbllokëve dhe në mbrëmje sulmoi qytetin nga ana e Ravonikut. Batalioni i 3-të arriti në objektivin e tij dhe ndau

forcat për të sulmuar Bilishtin dhe për të prerë rrugën Bilisht-Greqi. Forcat e batalionit të 3-të hapën zjarr kundër gjermanëve që ndodheshin në Bilisht. Luftimet në Bilisht vazhduan të ashpra. Gjermanët u përqëndruan vetëm në disa fortifikata, ndërsa në Bilisht hynë forcat tona. Në këtë kohë, batalioni i 4-të, po këtë ditë sulmonte Korçën nga ana e Turanit në rrugën e Pogradecit. Pas luftimesh të ashpra, bashkë me forcat e tjera operative, hyri në qytet.

Më 29 tetor '44 forcat e batalionit të 3-të të Brigadës së 9-të Sulmuese goditën hitlerianët që ishin grumbulluar në rrugën e Follorinës. Në mbrëmje e kësaj dite partizanët rrethuan katundin Drenovë në kufirin grek. Pas një përpjekje të shkurtër partizanët u futën në katund. Në fillim hitlerianët nuk kundërvepruan, pasi kishin qëllim t'u merrnin krahët forcave partizane dhe t'i asgjësonin. Lufta u ndez e ashpër ndërmjet një pjese të partizanëve që ruante krahët dhe gjermanëve që kërkonin të bënin rrethimin. Pas dy orë luftimesh, trupat tona u tërhoqën duke lënë të vrarë partizanin trim Xhevat Poloska, i cili mbeti në fushën e nderit, duke sulmuar me guxim për t'i marrë armikut mitralozin që pengonte lëvizjet e shokëve. Armiku pati humbje në të vrarë e në të plagosur, sidomos në krahun nga sulmoi për t'i rrethuar forcat partizane.

Me tërheqjen e trupave gjermane nga qarku i Korçës, mori fund edhe historia e luftimeve të kësaj brigade të re të Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare.

Nderim dëshmorëve e luftëtarëve të lirisë të Brigadës 24-t sulmuese partizane

Më datë 4 tetor 1944 u krijua në Bicaj të Kukësit Brigada e 24-t Sulmuese Partizane.

Kjo datë do të kujtohet brez pas brezi si dita e krijimit të formacionit më të madh luftarak të krahinës së Lumës një ngjarje e shënuar, jo vetëm për popullin e Kukësit, por edhe për Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit tonë.

Kukësi janë shquar në historinë shumë shekullore të popullit shqiptar, për ideale të larta patriotike dhe dashurinë e madhe për atdheun ku kanë dhënë jetën me dhjetra luftëtar e patriot.

Partizanët e kësaj brigade luftuan heroikisht në betejën për çlirimin e Tiranës.

Me 24 -29 nëntor 1944 Brigada XXIV do të sulmonte për çlirimin e kryeqendrës historike të Veriut dhe terreni i saj i luftimit do të ishin kodrat e Bërdicës dhe të Beltojtës, përballë mbrojtjes së fortifikuar gjermane dhe artilerisë së rëndë të vendosur në Kalanë e Rozafës.

Me pjesëmarrjen në çlirimin e Tiranës dhe të Shkodrës, me 22 dëshmorët e rënë këtu, Brigada e XXIV e kaloi me sukses provën e saj historike. Brigada u shpërnda në maj 1945.

Mirënjohje e nderim për drejtuesit e kësaj Brigade, komandantin Ndreko Rino, hero i popullit dhe komisarin birin e Bicajve dhe Kukësit Abedin Shehu.

Nga gjiri i Kukësi kanë dalë luftëtarë trima që e sakrifikuuan edhe jetën, që nga Ramadan Zaskoci, Hasan Kërxfhaliu hero i popullit, deri tek dëshmori i fundit i luftës së Kosovës, Halit Coka, duke kontribuar për këto ditë lirie që jetojmë e gëzojmë ne sot.

Përulëmi me mirënjohje e nderim përpara veprës së dëshmorëve e luftëtarëve të lirisë të Brigadës 24-sulmuese partizane:

Abaz Peposhi, Dan Shahu, Elmaz Ademi, Gani

Duraku, Hakik Gjici, Idriz Gafurri, Maksut Rexhepi, Nuredin Braha, Osman Qenami, Ramadan Kotarja, Sabri Gjici, Sadik Palushi, Xheladin Mici, Vehbi Shehu, Sherif Smana, Imer Mata, Isuf Seferi, Islam Xahu, Emri Halilaj, Hasan Lika Gani Onuzi, Hysen Koka, Halil Hasa, Ibrahim Lleshi, Mahmut Neçi, Musli Halilaj, Ramadan Kaculi Rustem Shehu.

E vërteta e luftës Nacional-Çlirimtare e popullit shqipëtar as mund të mohohet, as mund të errësohet. Asnjë kontribut tjetër nuk mund të sillte çlirimin e Shqipërisë pa luftën e ushtrisë nacional-çlirimtare, ishte kjo luftë e partizanëve shqipëtarë që e vendosi Shqipërinë në anën e duhur të historisë dhe në krahun e aleancës më progresiste të kohës.



IN MEMORIAM

38 VJET PA DËSHMORIN E AVIACIONIT NDUE LOGU

Nga **GJIN MUSA**
Shkrimtar&Publicist

Tridhjetëetë vjet më parë u nda nga jeta e "BACA". Kështu e thërrisin i gjithë personeli i Regjimentit të Helikopterave Farke.

Ndue Logu lindi ne 8 Maj të vitit 1940 në Brashtë të krahinës të Dugagjinit të Shkodrës.

Kreu shkollën 7 - vjeçare në Shtëpin e fëmijes në Shkodër, gjithashtu mbaroj dhe shkollën ushtarake "SKENDERBEJ".

Me një grup kursantësh u dërgua në ish Bashkimin Sovjetik për tu përgatitur për pilot për avionin helikopter.

U inkuadrua për të shërbyer në Regjimentin e Helikopterave në Laprakë dhe më vonë në Farkë.

Gjatë karrierës ushtarake ai udallua si pilot dhe mori klasin e 2-të. Gjithashtu në rolin drejtues komandant skuadrilje e zv/Komisar regjimenti. Më pas Ndue Logu mabroi edhe kursin e Akademisë të Mbrojtjes. Më vonë u caktua me detyrën e shefit të armatimit.

Në datën 13 Shtator të vitit 1986 Reparti kishte planifikuar qitje në poligonin afër repartit. Kishin në plan përdorimin e granatave luftarake. Ushtari që kishte granatën në dorë, pasi i hoqi siguresën u hutua dhe koha po ecte. Në këtë moment "BACA" ja merr nga dora por koha maroj e ajo shpërtheu duke i marrs jetën "BACËS"

Ai ra në krye të detyrës duke kryer aktin heroik për të shpëtuar jetën e ushtarëve.

Ky ishte Dëshmori i Atdheut (Aviacionit).

Shkrimtari dhe publicist i mirënjohur Gjin Musa ka hedhur kujtimet për Dëshmorin në librin e titulluar "SHQIPONJA E DUGAGJINIT"

Lavdi jetës dhe veprës te Tij.



REPORTAZH

POGRADEC, AMBIENT MODEL NË NDERIM TË DËSHMORËVE

Prof.asoc.dr. Bernard ZOTAJ
Mjeshtër i Madh

- **Kujtimi i dëshmorëve nuk është vetëm detyrë morale, por është edhe një mënyrë për të ruajtur identitetin tonë kombëtar dhe për të edukuar brezat e ardhshëm me ndjenjën e dashurisë për atdheun**

Zyra e Degës së Dëshmorëve në Pogradec është tashmë një shembull i vërtetë i përkushtimit dhe respektit ndaj atyre që dhanë jetën për atdheun. Kjo zyre gjendet në ambientet e godinës së bashkisë Pogradec. Falë përpjekjeve të vazhdueshme të kryetarit të degës, Eqber (Berti) Çami, ky ambient është transformuar në një hapësirë dinjitoze, me vlera të thella historike e atdhetare, që reflekton ndershmërinë e kujtesës dhe vlerësimin ndaj figurave që kanë shkruar me



gjak historinë e këtij vendi.

Ky transformim nuk do të ishte i mundur pa ndihmën dhe kontributin bujar të dashamirësve të Organizatës së Dëshmorëve. Ndër ta, veçojmë Flamur Kaziu, nipi i dëshmorit Mustafa Gjinishi, dhe Jorgo Qirko, pasardhës veterani, të cilët dhuruan

një kompjuter me printer, si dhe disa korniza me foto me ngjyra të dëshmorëve të Bashkisë Pogradec dhe të drejtuesve të kësaj dege ndër vite. Këto elementë nuk janë vetëm pajisje apo dekorime, por bartin një simbolikë të thellë, duke sjellë më pranë brezave të rinj figurat e atyre që sakrificuan gjithçka për lirinë.

Kontributi i tyre është një pasuri e çmuar për këtë zyrë. U dhuruan libra e shkrime për dëshmorët e Pogradecit, duke pasuruar më tej përmbytjen historike dhe edukative të ambientit.

Falë këtyre përpjekjeve dhe bashkëpunimeve, zyra ka marrë një pamje të re, duke u shndërruar në një vend të këndshëm, mikpritës dhe frymëzues për këdo që e viziton. Ajo nuk është më thjesht një hapësirë institucionale, por një vend ku ndihen gjurmët e historisë, respekti për të kaluarën dhe fryma e sakrificës.

Kjo përvojë suksesi duhet të shërbejë si një nxitje për individë të tjerë, për komunitetin dhe institucionet që të kontribuojnë në ruajtjen e kujtesës historike dhe në nderimin e figurave të lavdishme të kombit.

Sepse kujtimi i dëshmorëve nuk është vetëm detyrë morale, por është edhe një mënyrë për të ruajtur identitetin tonë kombëtar dhe për të edukuar brezat e ardhshëm me ndjenjën e dashurisë për atdheun.



DOSSIER

Vrasja e Mahmut Dacit, Met Hysenit dhe shokëve të tyre pati jehonë të madhe

• ***Pas disa viteve lufte osmanët u detyruan të tërhiqen nga organizimi qendor i pushtetit dhe emruan në vitin 1872 Met Hysenin si Kadi të Kazasë së Lumës. Gjithsesi nuk u ruajt qetësia sepse pashallarë të ndryshëm merrnin përsipër nënshkrimin e Kalisit dhe të Lumës.***



Nga Sakip Cami

Sipas gjurmimeve që ka bërë Ing. Agim Hasalami, pasardhës brezash i Mehmet Hysenit nga Kalisi i Lumës, fisi i Hasalamit të Kalisit është i dokumentuar për herë të parë në vitin 1575 me Hasanin si timarmbajtës të fshatrave Trullishte, Kashanje dhe Ajdovan.

Hasani së bashku me Kokën dhe Matën kishin ardhur në Kalis nga Tplani i Krasniqes dhe në Tpla nga Boksi i Pultit. Ata përbënin grupimin fisnor të quajtur Boks.

Fise të vitit 1591 janë Koka, Mata, Hasani (Hasalami dhe Murati) dhe Micoli, të grupit të Boksit. Të grupit të Bytycit janë Gjana, Ymeri, Elezi, Shahini si dhe Tota, Nuza, Hysa, Kaca, Kica.

Si timarmbajtës për fshatin Kalis ishte Sulejmani i Hasanit. Për fshatin Gështenjë e Ajdovan ishte Rizvani i Hasanit dhe për fshatrat e tjera ishte Hyseni i Hasanit. Në këtë kohë Rizvani bashkë me dy familje të tjera dolën te mulliri i Zall Kalisit ku ndërtoan dhe mullirin.

Kjo kohë qetësie dhe organizimi për Kalisin mbaroi shpejt sepse filluan sulme të përvitshme me ushtri të mëdha nga pashallarë të ndryshëm osmanë. Dibranët, lumjanët dhe matjanët iu kundërvunë sulmeve osmane me organizimin e Kuvendit të Dukagjinit në kishën e Shënllëshnit (Zall Dardhë) në vitin 1601-1602. (Selami Pulaha, "Qëndresa e popullit shqiptar kundër sundimit osman nga shekulli XVI deri në Shek XVIII, dokumente osmane, faqe 49 si dhe dokumentacioni i Vatikanit)

Njësi Kaza' vetadminstruese në fillim u njoh Kalisi, pastaj Kalaja e Dodës dhe pas bashkimit me njësi të tjera, Luma u shpall kaza. (Historia e Shqipërisë, Vëllimi II faqe 49, botim i vitit 1984.) Pra Luma ishte kaza' në sanxhakun e Priz-

Mehmet Hyseni (1825 – 1876), bashkëluftëtar me Mahmut Dac Kalisin

renit , vilajetin e Kosovës.

Tani të kthehemi te fisi dhe familja Hasani që më vonë u vendos në lagjen Lamë dhe mori emrin Hasalami

Emri i kësaj familjeje del i dokumentuar me përfaqsesin e vet Mehmet Sherif Efendi në Janinë para vitit 1807. Mehmet Sherifi ishte i shkolluar në Turqi dhe është shkruesi i shumë dokumentave në oborrin e Ali Pashë Tepelenës.

Mehmet Sherifi nuk u kthye nga Janina në Kalis. Ai la një djalë, Hysenin.

Hyseni lindi tre djem Mehmetin (Met Hyseni), Sherifin dhe Vokën.

Në këtë kohë Luma ishte aneksuar nga Bushatllinjët dhe sistemi autonom i Kazasë nuk funksiononte. Lumjanët sikurse të gjithë shqiptarët ishin përfshirë në lëvizje qëndrese kundër reformave të Tanzimatit dhe kundër Perandorisë Osmane, për autonomi.

Pas largimit të Bushatllinjve erdhi nevoja për funksionimin e Kazasë dhe Hyseni dërgoi në shkollën e Kadilerëve në Stamboll të birin, Met Hysenin. Meti studioi për drejtësi dhe mori titullin kadi. Paralelisht me studimet për drejtësi mori leksione për mjekësi dhe shërbeu në Kalis për mjekimin e të sëmurëve,

profesion që ua transmetoi edhe brezave të tjerë të familjes.

Ndërkohë që Met Hyseni ishte për studime filloi reforma e Tanzimatit që hoqi pushtetin e Kadilerëve. Mehmeti sikurse shumë shqiptarë të tjerë mori pjesë në Luftën e Krimesë dhe luftërat në Detin e Zi kundër Ruisë, ku mësoi në perfeksion artin e luftës me transhe, llogore, hendeklidhje dhe përdorimin e armëve të reja të kohës.

Në kontakt me atdhetarët shqiptarë në Stamboll ai vendosi të kthehej në Kalis me disa ndihma monetare që do të shërbenin për blerje armësh dhe municionesh.

Ndërkohë Luma nën drejtimin e Mahmut Dacit e kishte frenuar zbatimin e reformës së Tanzimatit dhe pas më shumë se 20 vjet lufte kishte formuar një pushtet me Bajraqe që drejtohehin me patriotë vendas.

Studiuesi dhe mbledhësi i folklorit Munir Shehu në librin e tij e quan Mahmut Dacin qeveri më vehte dhe e krahason me Ali Pashë Tepelenën. Pra, Luma, Kalisi dhe drejtuesit e tyre ishin bërë shqetësim për Portën e lartë, e cila urdhëroi dhe aktivizoi tre pashallarë për kapjen dhe vrasjen e Mahmut Dacit. Shoqëru-

si i Mahmut Dacit në këtë kohë dhe kadi për Lumën ka qenë Met Hyseni. Pas vrasjes së tij vula e kadiut është dorëzuar në Prizren. Ka të dhëna që akoma ruhet në Mitrovicë.

Studiuesi i mirënjohur nga Luma Prof. Shefqet Hoxha shkruan:

"Duke gjurmuar në Arkivin e Institutit të Historisë së Akademisë së Shkencave, në fondin "Arkivi i Vjenës", i përkthyer dhe i depozituar aty, hasa në dy dokumente që flasin për Mahmut Dacin e Kalisit.

Të dy dokumentet i përkasin vitit 1876 dhe janë të nënshkruar nga konsulli austro-hungarez i Prizrenit, Lippich, i cili informonte kryekonsullatën në Shkodër dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, në Vjenë.

DOKUMENTI I PARË (VJ.87-16, PRIZREN, 27 PRILL 1876)

Dokumenti i parë (Vj.87-16, Prizren, 27 prill 1876) thotë shprehimisht:

"Dje arriti këtu Mahmut Daci, që ia kanë frigën të gjithë, me një shpurë prej vetëm 20 vetësh, ndër të cilët edhe kadiu i Lumës, (Sipas dokumentave të kohës del që ishte Met Hyseni, shënimi im S.C.) që ka

(Vijon në faqen 7)

DOSSIER

në popull, në Portën e lartë dhe në kancelaritë e huaja

Mehmet Hyseni (1825 – 1876), bashkëluftëtar me Mahmut Dac Kalisin

(Vijon nga faqja 6)

aq nam të keq si kusar dhe strehues kusarësh. Ai shpreson të emërohet komandant i xhandarmërisë së rrethit të tij.

Të dy personalitetet interesante na nderuan në vizitën e tyre, gjë që unë si zor mund ta refuzoja, dhe, me fjalë të shumta, afirmuan pafajësinë e tyre në eksese të lumjanëve dhe vunë në pah reciprocitetin e tyre për të mirën publike. Gjëja më konkrete në ekspozitën e tyre ishte propozimi që të ndërhyja që t'u jepeshin atyre poste dhe grada të paguara më së miri. Mendova se bashkëveprimin e lypur të mos ua refuzoja, aq më pak, mbasi shpura e tyre e armatosur vetëm me fjalë të mira u kandis që të qëndrojnë jashtë konsullatës, gjatë kohës që të dy shefat ishin mbrendë”.

Sqarojmë lexuesin se fjalët kusar e strehues kusarësh për Mahmut Dacin, kadiun dhe shoqëruesit e tyre janë përdorur nga osmanët dhe diplomatët e tyre për të krijuar opinionin e domosdoshmërisë së vrasjes së tyre si prishës rendi, gjë që ndodh shpesh në raportet e ushtrive të huaja pushtuese.

DOKUMENTI I DYTË (VJ.87-15, PRIZREN, 23 KORRIK 1876)

Dokumenti i dytë (Vj.87-15, Prizren, 23 korrik 1876) është shumë më i gjatë, por flet shkurt për Mahmut Dacin, madje vetëm sa e përmend emrin e tij:

Pas ardhjes së Mehmet Hysenit nga Stambolli, lufta për autonomi (kthimin e sistemit të Kazasë u riaktivizua përsëri ku forca ushtarake e mbledhur ishte me mijra luftëtarë lumjanë dibranë dhe matjanë.

Sulmet e vazhdueshme bënë të detyrueshme mbrojtjen xhenjere, ndërtimin e transheve (tabeve) që mbronin Kalisin, Vilën dhe Draj-Recin.

Lufta e Kalisit në keto vite u zhvillua duke bërë një vijë mbrojtje (Tabe) me gjatësi rreth 25 kilometra. E gjithë popullsia brenda kësaj vije mbrojtje ishte plotësisht në funksion të luftës. Vija e mbrojtjes ishte: Qaf- Drajë-Barruc-Voren - Korrosop-Sukë-Shullan, Paradin-Lenishte-Bumontroll-Kodra e ftohtë-Drini i Zi. Në këto luftime pati shumë luftëtarë të vranë. Përveç luftëtarëve nga Kalisi, Vila dhe Reci kishte edhe luftëtarë nga Arrni, Lura, Dardha, Cidhna, Muhurri, Katër Grykët, Fani, Selita, Kthella, Macukulli, Martaneshi, Cermenika, etj.

Pas disa viteve lufte osmanët u detyruan të tërhiqen nga organizimi



Kulla e Hasalamit viti 1800

qendor i pushtetit dhe emruan në vitin 1872 Met Hysenin si Kadi të Kazasë së Lumës. Gjithsesi nuk u ruajt qetësia sepse pashallarë të ndryshëm merrnin përsipër nënshkrimin e Kalisit dhe të Lumës.

Met Hyseni në prill të vitit 1876 bashkë me Mahmut Dacin takuan Konsullin austriak në Prizren ku u ofruan për bashkëpunim me Austriakët.

Për vrasjen e Mahmut Dacit, Met Hysenit dhe të shokëve të tyre u organizua një kurth i mirëpërgatitur nga Porta e Lartë.

Met Hyseni u vra në një ditë dhe në një vend me Mahmut Dac Kalisin në një kurth të ngritur në Bumontroll në korrik të vitit 1876 bashkë me 39 përfaqësues të tjerë të fiseve të Kalisit, Vilës dhe Reçit.

Kur u vra Mahmut Daci, në Bumontroll u vranë mbi 50 nizamë. Nga të Mahmutit u vra shoku i tij i luftërave, Bajram Uka dhe Rexhë Kalisi, Met Hyseni dhe u plagos Tel Bodini. (Munir Shehu shkruan: U plagos vëllai i Lud Bodinit)

Një këngë popullore e hershme thotë:

“...Met Hyseni e Tel Bodini

Po luftojnë si djem veziri”... (Xhemali Prendi “Kalisi kështjellë trimërie”)

Munir Shehu shkruan: “Turqit e Demir Pashës filluen me e gjuajt kullën me top. Qysh prej asaj dite dhe sot, vendi ku qe vendos ky top quhet “Bumullatroll”, d.m.th. bubullonte trolli (toka, dheu), kur shtinte topi.

Gjylet shpërthenin e ndizeshin flakë mbrenda... Për organizimin e këtij kurthi dhe këtij sulmi kishin bashkëpunuar Veziri i Shkodrës, pashai i Prizrenit dhe pashai i Gjakovës që ishin kundra Mahmut Dacit. (Munir Shehu)

Djalit (barrë në barkun e nënës në momentin e vrasjes së Metit), i vunë emrin Mehmet sipas amanetit të tij.

Vrasja e Mahmut Dacit, Met Hysenit dhe shokëve të tyre pati jehonë të madhe në popull, në Portën e lartë dhe në kancelaritë e huaja.

Dy vjet më vonë, në Dibër të poshtme Abdyl Frashërin e priti Ahmet dhe Jusuf Bej Karahasani dhe gjatë qëndrimit në qendrën e Dibrës së poshtme në Kastriot, Ab-

dyl Frashëri i kërkoi Karahasanit të thirrte Sherifin, vëllain e Met Hysenit që t'i shoqëronte nëpër Lumë deri në Prizren.

Djemtë dhe pjestarët e familjes Hasalami e vazhduan luftën për liri dhe pavarësi kundër turqve dhe serbve, por kjo do të jetë objekt i një shkrimi tjetër.

Burimet:

1. Fatos Daci, “Mahmut Daci, jeta dhe vepra e tij”
2. Kangë të Rilindjes Kombetare, 1978
3. Shënime të Ing. Agim Hasalami
4. Xhemali Prendi “Kalisi, kështjellë trimërie”
5. Munir Shehu, “Mahmut Daci ishte qeveri më vehte”, Histori dhe folklor nga Dibra
6. Dokumenti (Vj.87-16, Prizren, 27 prill 1876) nënshkruar nga konsulli austro-hungarez i Prizrenit, Lippich, i cili informonte kryekonsullatën në Shkodër dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, në Vjenë.

82-VJETORI

Brigada i dha atdheut jetën e 256 luftëtarëve të cilët kujtohen e nderohen në breza

KUR BRIGADA E 3-të QËLLOI ME TOP ASAMBLENË TRADHTARE



Artileria e brigadës goditi Asamblenë tradhtare

Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj
Mjeshtër i Madh

ORGANIZIMI I BRIGADËS U BË NË LUFTË...

Në luftë me pushtuesit gjermanë, më 9 tetor 1943, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në fshatin Arbanë, të Pezës heroike u formua Brigada III Sulmuese (Br. III S). Në brigadë u inkuadruan formua njësitë partizane të rrethit të Tiranës, si dhe shumë të rinj të qytetit të Tiranës që ju përgjigjën thirrjes së UNÇSH. Shumica e luftëtarëve të brigadës ishin luftëtarë të vjetër, me eksperiencë dhe të kalitur në beteja të ashpra kundër pushtuesit. Brigada i nisi luftimet me dy batalione të Grupit Partizan të Pezës, nga batalioni Krujë-Ishëm, batalioni "Dajti", si dhe çeta "Mateoti" dhe partizanë të njësiteve guerile të ardhur nga qyteti i Tiranës. Në shtabin e Br. III S u caktuan Hulusi Spahiu, komandant; Shahin Ruka, komisar; Hamit Keçi, zëvendëskomandant; Vasil Nathanaili, zëvendëskomisar dhe Thoma Kalefi intendent. Nazistët gjermanë e diktuan grumbullimin e forcave partizane për formimin e brigadës dhe një ditë më pas, sulmuan me forca të shumta në drejtim të Arbanës, ku ishin përqendruar njësitë e kësaj brigade duke e vënë në pozitë të vështirë, si dhe Grupin e Pezës. Partizanët ju përgjigjën me kundërsulm të shpejtë. Luftimet që u zhvilluan ishin të ashpra dhe përlëshja arriti deri në trup me trup. Armiku pësoi humbje dhe u detyrua të tërhiqej. Ky ishte dhe pagëzimi i parë luftarak i brigadës. Për Luftën e Arbanës, ko-

mandanti gjerman, Herman Fran, do të shkruante në shënimet e tij, se "... dielli kishte vendosur të mos perëndonte kurrë atë ditë", ndërsa më poshtë do të vazhdonte "në këtë aksion të parë të vërtetë të gjermanëve në Ballkan dukej sikur gjithçka ishte përbetuar kundër nesh".

Pas suksesit në Luftën e Arbanës, brigada u përqendrua në rajonin e Ballhaxhias dhe të Dorëzimit. Nga këto pozicione të përshtatshme filloi lëvizjen për të zbatuar urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm për të goditur asamblenë tradhtare. Kështu më 18 tetor 1943, kur anëtarët e Asamblesë Tradhtare, krerë të përfaqësuesve të organizatave që bashkëpunonin me pushtuesin u mbledhën për të legalizuar pushtimin hitlerian të vendit tonë, artileria e brigadës, e vendosur në kodrat e Saukut, qëlloi godinën e pallatit ku ishte mbledhur asamblenja. Goditja ishte përgjigja që po i jepte populli shqiptar aktit të turpshëm të tradhtarëve në kurriz të popullit shqiptar. Pas këtij aksioni, luftëtarët e Br. III S përballuan me trimëri në ditët në vijim sulmet e vijueshme të organizuara nga armiku në të gjithë zonat që rrethonin kryeqytetin, Tiranë. Brigada që me formimin e saj, ju desh të luftonte në kushte jashtëzakonisht të vështira dhe në terren ku armiku kishte kushte të favorshme për të sulmuar nga shumë drejtime. Ndër luftimet më të ashpra të saj janë luftimet që u zhvilluan gjatë operacionit armik në Pezë e Çermetnikë. Në fillim të nëntorit 1943, trupa të shumtë fashistë gjermanë sulmuan Pezën nga shumë drejtime, me qëllim për të asgjësuar këtë njësi luftarake. Brigada së bashku me forca territoriale të Pezës, hynë në luftime të ashpra me armikun nga të gjitha drejtimet.

Por, pas katër ditë me luftime, duke sulmuar, mundi të çajë rrethimin dhe doli nga zona e Pezës. Me daljen e saj nga zona e nxehtë e Pezës, ajo përsëri u gjend në luftime në zonën e Çermetnikë dhe të qarkut të Elbasanit. Së bashku me forcat partizane të Br. II S, goditën në befasi forcat nazistë gjermane brenda në qytetin e Elbasanit. Kështu në vijimësi brigada ka mbajtur disa herë me radhë nën goditjet e saj rrugën automobilistike Elbasan-Tiranë, duke e bërë të pakalueshme për armikun. Nazistët gjermanë, duke e ndjerë veten të kërcënuar, grumbulluan forca të shumta dhe, të ndihmuar nga tradhtarët e forcave bashkëpunuese sulmuan Çermetnikën, ku ndodheshin dhe forcat kryesore të Br. III, II S dhe një pjesë e Shtabit të Përgjithshëm. Luftëtarët e Br. III, II S, megjithëse në kushte të vështira, të terrenit dhe të ftohtit, të urinë, të veshjes së paktë dhe të keqe, luftuan trimërisht kundër një armiku shumë herë më të madh në njerëz dhe të pajisur me të gjitha mjetet luftarake të kohës. Rrethimi i bërë nga forcat naziste u çoi me vështirësi të mëdha dhe njësite e repartet e tyre kaluan në zona të tjera në Jug të Shqipërisë.

BRIGADA ME LUFTIME MBËRRITI DERI NË JUNIK

Operacioni i Qershorit 1944 e gjeti Br. III S me luftime në zonën e Skraparit. Me luftë të vazhdueshme kundër forcave armike, gjatë operacionit, ajo kishte fituar përvojë luftarake dhe doli me humbje të pakta. Luftëtarët kishin fituar përvojë dhe ishin të kalitur, për të bërë beteja edhe më të vështira. Me kalimin e Div. I S në Veri të vendit, Br. III S më 19

- Në radhët e Br. III-të S luftuan me heroizëm mbi 50 luftëtarë (gra dhe vajza) të cilat në moshë të re u rezistuan privacioneve të luftës. Shumë prej tyre drejtuan rininë dhe ishin në shtabet e batalioneve e të kompanive, ku midistyre ishin dhe Heroinat e Popullit Emine Bahja dhe Ylbere Bilibashi, si dhe Heronjtë e Popullit, Myslim Keta, Rahman Parllaku dhe Rexhep Kolli

korrik 1944 kaloi Shkumbinin dhe u përqendrua në zonën Tiranë-Elbasan, aty ku kish luftuar në ditët e para të formimit të saj, por që terreni dhe fshatrat dhe njerëzit ishin të njohur për të. Pas goditjeve të njëpasnjëshme gjatë muajve, korrik, gusht e shtator, brigada spastroi nga armiqtë zonën për rreth Elbasanit e Tiranës dhe, në bashkëveprim me forcat e Div. I S, goditi armikun pranë Tiranës, duke e detyruar të mbyllet në qytet. Më 20 shtator 1944, duke zbatuar urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm, marshoi nëpër zonat Tiranë-Martanesh-Peshkopi-Lumë-Malësi e Gjakovës dhe duke i kombinuar veprimet me forcat e Br. V S, luftoi kundër forcave të Muhamrem Bajraktarit, si dhe forcave hitleriane në Kukës. Me luftime të ashpra, një pjesë e forcave të Br. III S më 8 tetor kaloi Drinin e Bardhë, hyri në krahinën e Krumës e të Hasit dhe më 16 tetor 1944 çliroi Tropojën, kurse shumica dërmuese e brigadës kishte kaluar kufirin për të ndjekur armikun në Kosovë. Në këtë kohë Br. III S bashkë me Br. V S u inkuadruan në Div. V S. Pas luftërash të ashpra partizanët e Br. III S çlijuan Junikun. Në këtë mënyrë u çel rruga për çlirim-in e qyteteve të tjera të rëndësishme të Kosovës nga brigadat partizane të Shqipërisë që ishin dërguar me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm për çlirim-in e popullit Kosovar, nga pushtuesit nazistë gjermanë, si dhe nga tradhtarët e vendit. Partizanët e Br. III S si dhe të Br. V S me luftime të ashpra, në kon-dita të vështira, duke qenë gjithmonë përballë forcave superiore armike çli-ruan pas luftimesh të ashpra qytetet Gjakovë, Prizren dhe Pejë, ndërsa Pr-

(Vijon në faqen 9)

81-VJETORI

DËSHMORI I ATDHEUT ARIF MARKJA, KRENARI E FAMILJES DHE E FISIT

• Në luftën për çlirimin e Junikut të Gjakovës të Kosovës, në luftën kundër gjermanëve e tradhëtarëve të vendit, ra heroikisht më 23 tetor 1944, në moshën njëzet e katër vjeçare edhe Arif Abedin Markja...

Nga Skënder MURRJA*

Në fundin e shekullit të XVII-të, në fshatin Zogje, të Njësisë Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, jetonte edhe fisi "Markja".

Si shumë fise të tjera të këtij fshati malor, për arsye veçanërisht ekonomike, edhe familje të fisit "Markja" u shpërngulën drejt fshatit Gjoricë, Bashkia Bulqizë dhe fshatrave Reshan, Bohmovë e Ballancë, Komuna Dibër e Madhe.

Halla Rufie, motra e babait, u martua me Abedin Marken nga Ballanca. Nga kjo martesë lindën tre fëmijë Selimi, Nazja e Arifi.

Arifi lindi më 3 maj 1920 në një familje me gjendje të mirë ekonomike. Gjyshi i tij, Ali Markja, ishte burrë i njohur dhe lëvizte në Shehër të Dibrës e kudo me kalë me shalë.

Rreth vitit 1921, kur Arifi ishte një vjeç, familja e tij lëvizte nga Ballanca për në Gjoricë. Në atë kohë forcat serbe ushtruan dhunë mbi popullsinë vendase duke vrarë civilë të pafajshëm dhe dogjën shumë shtëpi e stalla bagëtish në Shehër të Dibrës e më gjerë. U dogj dhe shtëpia e Arifit. pjesëtarët e familjes ikën vetëm me rrobat e trupit duke lënë gjithçka në tmerrin e flakëve. Arifi shkollën fillore e kreu në Gjoricë.

Rreth vitit 1932, familja e Arifit



Arif Abedin Markja, Dëshmor i Atdheut (1920-1944)

lëviz për në Tiranë dhe vendoset në "Rrugën e Dibrës". Aty ku banonte, Arifi punoi si çirak në një dyqan biçikletash dhe bleu një aparat fotografik për të fotografuar. Kështu në moshë fare të re filloi punën. Ishte i shkathët dhe kishte shumë shokë.

Më 1942 organizohet në grupet e rinisë komuniste dhe lidhet me lëviz-



jen Nacionalçlirimtare. Shtëpia e tij u bë bazë e rëndësishme mbledh-jesh, grumbullimi materiale propogantistike dhe luftarake. Me mbështetjen e vëllait, Selimit, ai ndihmoi ilegalët për dalje nga qyteti i Tiranës.

Ishte aktiv në demonstrata, në shpërndarje komunikatash, në transportim të materialeve propagandistike

nga një bazë në tjetrën.

Në verën e vitit 1943 inkuadrohet partizan në grupin e Pezës, më pas vullnetarisht në Batalionin e III-të të Brigadës së III-të Sulmuese, ku merr pjesë në të gjitha luftimet që bëhen në këtë periudhë.

Në fillim të tetorit 1944 Brigada e III-të Sulmuese marshoi në intenerarin Guri i Bardhë - Klos - Bulqizë - Zerqan - Peshkopi - Lumë, me synimin çlirimin e Tropojës dhe Junikut e Kosovës. Një pjesë e intenerarit të marshimit, për arsye sigurie, ishte rruga Zerqan - Boçevë - Kovashicë - Stushaj - Mazhicë - Hotesht-Vau i Drinit të Zi -Peshkopi. Autokolona duke marshuar nëpër Hotesht, kalon nëpër oborrin e shtëpisë së prindërve. Vëllezërit, Selim e Arif Markja, partizan të kësaj Brigade, siç kanë treguar prindërit, ishin shkëputur nga autokolona dhe në mënyrë të beftë futen në shtëpinë e dajave, në katin e dytë, në dhomën e ndenjes. Përqafohen dhe bisedojnë përzemërsisht me të gjithë pjesëtarët e familjes. Prindërit ju ofruan që të hanë mëngjes, por ata nuk pranuan pasi nuk kishin kohë. Konsumuan diçka shpejt e shpejt dhe u ngritën për t'u larguar. Në këtë çast, dajat Ramizi e Dalipi, i kërkojnë Selimit që të mos e marrë Arifin me vete se është i vogël. Por, Arifi ndërhy duke thënë se unë do të shkoj se kam detyrime si partizan dhe se nuk mund ta lë vëllain vetëm. Pas kësaj, u përshëndetën përzemërsisht dhe u ndanë. Ky që takim i fundit i Arifit me dajat.

Në mbrëmjen e 22 tetorit 1944 Shtabi i Brigadës së III-të Sulmuese filloi manovrimin e forcave partizane me qëllim shpartallimin e armikut në sektorin qëndror, Junik të Gjakovës. Për arritjen e pozicioneve të sipërme, lëvizja e batalioneve u krye gjatë natës. Në mëngjesin e datës njëzetetete tetor, kur sapo kishte aguar, në pyllin mbi kodrat e Batushit, ku marshonte batalioni i III-të dhe i IV-t, buçiste zjarri i pushkëve e mitralozave. Armiku ishte i vendosur në pozicionin kodrinor mbi Batush, për të ndërprerë rrugën për në Junik. Batalionet manovrojnë me shpejtësi, vendosen në vijën frontale dhe fillojnë sulmin mbi pozicionet e armikut. Pas katër orë luftimesh të përgjakshme, batalioni i III-të dhe i IV-t e spastruan rrugën për Junik dhe u vendosën mbi kodrat sipër tij. Në ora 17:30, forcat e Brigadës së III-të Sulmuese hyjnë në Junik, armiku u detyrua të tërhiqej me shumë humbje në njerëz e mjete. Në luftën për çlirimin e Junikut të Gjakovës të Kosovës, në tokën e ish Jugosllavisë, në luftën kundër gjermanëve e tradhëtarëve të vendit, ra heroikisht më 23 tetor 1944, në moshën njëzet e katër vjeçare edhe Arif Markja.

Varri i tij ndodhet në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, në Tiranë.

(Marrë nga libri "Po kthehem në Hotesht")

KUR BRIGADA E 3-të QËLLOI ME TOP ASAMBLËNË TRADHTARE

(Vijon nga faqja 8)

ishtinën e çliruan më 20 nëntor 1944. Në këtë mënyrë të dy brigadat shqiptare shpejtuan çlirimin e popullit vëlla kosovar nga pushtuesit e tradhtarët. Populli kosovar është dëshmitar i luftës, i trimërisë e heroizmit të partizanëve shqiptarë, por ai është dëshmitar edhe i vështirësive dhe sakrificave që bënë luftëtarët e dy brigadave. Populli kosovar i priti vëllezërit shqiptarë me gëzim dhe u dha përkrahje si dhe ndau kafshatën e bukës me vëllezërit e tyre çlirimtarë.

FURNIZOI ME KUADRO NJËSITË PARTIZANE DHE MORI LAVDI

E inkuadruar në Div. V S, brigada vazhdoi luftimet kundër gjermanëve në thellësi të tokës jugosllave. Të njohura janë luftimet e brigadës kundër gemanëve, të cilët bënë përpjekje për të kaluar lumin Bistricë në drejtim të Malit të Zi. Kudo Br. III S luftoi me trimëri dhe justifikoi besimin që i dha Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, duke u kthyer në Atdhe e mbuluar me lavdi. Br. III S u kthye në një fidanishte kuadrosh. Nga radhët e saj dolën kuadro që e drejtuan atë në vazhdimësi. Nga kjo brigadë shumë kuadro shkuan drejtuan njësi të fuqishme luftarake si Div. V S e Div. VI S, si dhe në Br. XVIII, XXIII, XXIV, XXV S, etj. Në radhët e Br. III S luftuan me heroizëm mbi 50 luftëtarë (gra dhe vajza) të cilat në moshë të re u rezistuan privacioneve të luftës. Shumë prej tyre drejtuan rininë dhe ishin në shtabet e batalioneve e të kompanive, ku midis tyre ishin dhe Her-

oinat e Popullit Emine Bahja dhe Ylberë Bilibashi, si dhe Heronjtë e Popullit, Myslim Keta, Rahman Përlaku dhe Rexhep Kolli. Brigada i dha atdheut jetën e 256 luftëtarëve të cilët janë yje të pashuar të lirisë dhe kujtohen e nderohen në breza.

KOMANDANT, HULUSI SPAHIU

Hulusi Hasan Spahiu ka lindur në qytetin e Gjirokastrës në vitin 1913 në një familje qytetare me ndjenja të shquara atdhetare e antifashiste. Me përfundimin e Shkollën Ushtarake Mbretërore në vitin 1933 me rezultate të mira për artileri, gradohet nëntoger. Në vitin 1936 shkoi vullnetarisht në brigadat ndërkombëtare për të luftuar në Spanjë dhe këtu u gradua toger e kapiten. Nga gushti i vitit 1943 rreshtohet si organizator në forcat partizane të Pezës. Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm emërohet komandant i Br. III S. Në këtë detyrë qëndroi deri në muajin nëntor të vitit 1944 dhe drejtoi të gjitha luftimet që zhvilloi brigada. Në nëntor 1944, Hulusi Spahiu u graduar nënkolonel dhe u emëruar shef i shtabit të Korparmatës I Sulmuese. Në janarin e vitit 1945 emërohet komandant i Komandës së Artilerisë të Ushtrisë pranë Komandës së Përgjithshme. Në vitin 1952 dërgohet për studime të larta specializimi në Akademinë e Artilerisë në BS. Pas kthimit nga specializimi emërohet komandant i Artilerisë. Në vitin 1954

(Vijon në faqen 11)

PROFILI

Më 15.10.1982, e zuri "Fshesa e dytë e hekurt" ndaj kuadrove të larta të Ushtrisë Popullore.

MALIQ SADUSHI GJENERALI I MENÇURISË LABE

- *U formua si oficer i lartë, me gjykim të thellë, me mendime të pjekura për artin ushtarak popullor, për teorinë dhe shkencën ushtarake në përgjithësi, duke u vlerësuar nga kolegët, eprorët dhe vartësit si pjesë e korpusit të të urtëve të Ushtrisë sonë Popullore, që e përmbushën misionin e tyre në kushtet nga më komplekset e kohës. Në Labëri vlerësohet si burri që shkroi historinë me pushkë dhe me penë*

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

**FSHATI VAJZË E MENÇURISË,
PATRIOTIZMIT, TRIMËRISË DHE
LAVDISË**

Kur flasim për fshatin Vajzë rrëzë malit të Beunit, këtë emër të njohur dhe të shquar në historinë e Vlorës, Labërisë, Shqipërisë, është e pamundur ta përfshijmë në pak rreshta fshatin e vlerave të rralla dhe që ka nxjerrë personalitete të të gjitha fushave. Fshati Vajzë me një emër kaq të veçantë dhe unik mbarëshqiptar është ndër fshatrat labe me mjaft tradita, vlera, histori me rrënjë amantine, e spikatur në histori, por mbi të gjitha me njerëz që i kanë dhënë shumë fshatit, Vlorës historisë labe dhe që kanë vendosur edhe për fatet e zhvillimet e vendit në shumë fusha të zhvillimeve shqiptare. Ndër bijtë e saj të shquar zë vend dhe gjeneral Maliq Sadushi, krahas figurave të tilla si Ali Asllani, Sulejman Rexhepi, Perlat Rexhepi, Lavdosh Ahmetaj etj. Fshati Vajzë është vendlindja e legjendës së trimërisë vajziote Hito Zenel Hitaj (shpallur dëshmor më 11.4.2025), poetit kombëtar Ali Asllanit, e heroit dhe dëshmorit të epopesë së tre heronjve të Shkodrës Perlat Rexhepit, por edhe i dy ish-ministrave; Lavdosh Ahmetaj dhe Maliq Sadushit, që edhe pse ishte Zvendësministër i parë i Mbrojtjes, duke qenë se Mehmet Shehu ishte edhe Kryeministër për shumë vite kreu detyrën në një nivel me Ministrat e tjerë në qeverinë shqiptare. Këtu në Vajzë gjen histori nga më të vjetrat e deri tek patriotizim dhe atdhedashurinë e pashterrshme, gjen epokat me njerëz të pushkës dhe të penës dhe të pushkës, që i kanë kaluar sinoret e fshatit Vajzë, të krahinës së Labërisë, por dhe më gjerë mbarë rrafshin kombëtar. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e gjen Maliq Sadushin ende të parritur me shpirt të zjarrtë që u lidh fuqishëm me formacionet e

ilegalëve të parë partizanë. Djaloshi 13 vjeçar ishte ndër më të rinjtë e organizatës së rinisë antifashiste duke qenë ndër të parët që u përfshi në radhët e saj. Në fillim të viteve 1942-1943 dhe në vijimësi lufta çlirimtare mori hov dhe Maliqin e gjejmë në formacionin e parë të çetës territoriale të Vajzës, në luftimet e Gjormit, e më tej pjesëmarrës në të gjitha luftimet, në muajin Korrik të vitit 1943, Maliq Sadushi rreshtohet si luftëtar në batalionin partizan "Ismail Qemali" të Vlorës dhe prej 28 Nëntorit 1943, me formimin e Brigadës së Pestë, në fshatin Gumenicë rreshtohet si partizan i thjeshtë dhe më pas komandant skuadre. Baza e BrVS edhe pse kishte pesë batalione ishte batalioni "Halim Xhelo" dhe "Ismail Qemali" me një efektiv prej më se 500 vetësh. Maliqi ishte pjesëmarrës në gjithë veprimtarinë luftarake të kësaj brigade heroinë nga dita e inaugurimit më 20.1.1944 në Bramyshnjë të Tërbaçit. Maliq Sadushi dhe të tjerë vajziotë të shumtë e pasuruan historikun e fshatit Vajzë dhe ridimensionuan atë falë mençurisë, patriotizmit, trimërisë, punës, fisnikërisë, njeri tërësisht i vërtetë dhe i vlerave të larta njerëzore.

**USHTARAKU MADHOR MALIQ
SADUSHI, NJË JETË E NDRERSHME
NË LUFTË DHE NË PUNË**

Maliq Sadushi lindi më 2.2.1928 në Vajzë të Vlorës. Rrjedh nga një familje me tradita të shquara atdhetare dhe patriotike si nga babai edhe nga nëna. Babai i tij dhe gjyshi nga nëna kanë marrë pjesë me armë në dorë në Luftën e madhe të Vlorës më 1920. Jeta e Maliqit ka qenë tejet e vështirë pasi në moshën 2 vjeç i vdiq nëna nëna dhe në moshën 4 vjeç edhe babai. Kështu që Maliqi i vogël u rrit jetim. Pavarësisht vështirësive të mëdha kreu shkollën fillore në fshatin e lindjes në Vajzë të Vlorës. Më 1939 detyrohet të fillojë punë për të përballuar jetën, kur ishte



vetëm 11 vjeç. Në vitin 1942 organizohet me grupin e të rinjve antifashistë të krahinës së Kudhësit. Rreshtohet partizan në çetën e Vajzës në moshën 14 vjeç, më pas në batalionin partizan "Ismail Qemali"; më tej jeta partizane e çoi në një prej formacioneve të mëdha dhe më të lavdishme të LANÇ-it, pasi në nëntor 1943 rreshtohet në Brigadën e 5-të Sulmuese dhe në dhjetor 1943 pranohet anëtar partie, sipas dokumentacionit dhe autobiografisë së tij. Maliqi i rreshtuar në radhët e Brigadës së 5-të sulmuese e ndoqi armikun deri përtej kufijve shtetërorë, në tokat shqiptare deri në Sanxhak të Jugosllavisë, duke kontribuar për çlirimin e shqiptarëve jashtë "Shqipërisë Londineze" dhe popujve të ish-jugosllavisë. Lufta e burrëroi, trimëroi, mënçuroi Maliqin, që e nisi luftën që femijë dhe në radhët e saj së bashku me moshatarët e tij.

Në shtator 1944, emërohet zëvendëskomisar kompanie. Lufta tashmë kishte marrë përmasa të mëdha në mbarë vendin, madje një pjesë e njësive luftarake në përbërje të dy divizioneve sulmuese kishin kaluar kufijtë administrativë të Shqipërisë, për t'u ardhur në ndihmë vëllezërve kosovarë në luftën kundër forcave germano-çetnike. Maliqi në këtë kohë ishte luftëtar i rreshtuar në Brigadën

XXV Sulmuese të Divizionit të 5-të Sulmues, të Ushtrisë Partizane Shqiptare. Është për t'u evidentuar dhe theksuar, se Maliqi në të gjitha luftimet ku mori pjesë u tregua i vendosur, luftarak dhe trim, me një aktivitet sinjifikativ luftarak, një prerje për ushtarak që gjatë luftës. Nga tregimet e bashkëmoshatarëve por mbi të gjitha nga dokumentet që flasin qartë dhe bindshëm gjejmë se, "Maliqi ishte luftëtar që në luftën e Gjormit në 31.12.1942 dhe 2.1.1943, lufta e Drashovicës më 14.9.1943 deri më 5.10.1943, Operacioni gjerman i Qershorit 1944 në Skrapar e Gramsh, luftimet në rrethinat e Tiranës, në Mullet, në shkallën e Tujanit, në Zall-Herr nga fundi i muajit Qershor-fillimi i muajit Korrik 1944, luftimet e Kukësit në shtator 1944, lufta e Gjakovës si dhe luftimet e Sanxhakut në Jugosllavi në fundin e vitit 1944-1945. V

eprimtari e tij gjithëpërfshirëse bëri që atë ta njohë trimin e luftëtarin e fshatit Vajzë jo vetëm Labëria, por mbarë Shqipëria. Kur citon aktivitetin luftarak të Maliqit dhe shokëve të tij në luftë në lulen e rinisë, jo vetëm brenda kufijve të Shqipërisë por dhe jashtë saj deri në Jugosllavi, shohim

(Vijon në faqen 11)

PROFILI



MALIQ SADUSHI GJENERALI I MENÇURISË LABE

(Vijon nga faqja 10)

qartë shprehjen e idealizmit luftarak, ndërgjegjen kombëtare, atdhetarizmin e vrullin rinor, që e shpërfillnin vdekjen në të gjitha ditët e luftës. Pas çlirimit të vendit rreshtohet në forcat e ndjekjes për asgjësimin e bandave diversioniste deri në 5 dhjetor 1945. Më pas caktohet shef i seksionit të sigurimit të ushtrisë pranë Komandës së Përgjithshme të UNÇSH-së. Pas një kursi një vjeçar caktohet komandant batalioni në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Pastaj kryen kursin për filozofi dhe ekonomi politike prej vitit 1955-1956.

Nga viti 1958-1961 kryen Studimet e Larta në Moskë në "Akademinë Ushtarake Frunxe". Në korrik 1962 emërohet komandant i Brigadës në Laç, e më pas Komandant i Brigadës së Këmbësorisë në Kukës. Prej 1968-1969 kryen Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm në Tiranë. Prej 1969-1973 caktohet shef shtabi Korpusi. Prej vitit 1973-1974 caktohet pedagog në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu".

Prej vitit 1974-1982 ka kryer detyrën e Zvendës Ministrit të Parë të Mbrojtjes Popullore dhe njëkohësisht deputet i Kuvendit Popullor për Vlorën dhe anëtar i Presidiumit të Ku-

vendit Popullor. Në mestetorin e vitit 1982 shkarkohet nga të gjitha detyrat shtetërore dhe nxirret në lirim padrejtësisht për dyshime si pjesëtar i "Komplotit" të Mehmet Shehut e Kadri Hazbiut. Maliq Sadushi ishte vetëm 54 vjeç kur u nxorr në lirim, një vit para se të mbushte moshën normale të daljes në pension, pasi ushtarakët

(Vijon nga faqja 9)

emërohet komandant i tankeve dhe gradohet gjeneralmajor. Në këtë post qëndroi deri ditën kur në vitin 1956, pas Konferencës së Tiranës, internohet në qytetin e Lushnjës dhe në vitin 1958 burgoset si kundërshtar politik i regjimit.

KOMISAR, SHAHIN RUKAJ

Shahin Rukaj, lindur më 4 prill 1918, në fshatin Matogji të rrethit Vlorë. Mësimet e para të fillores i mori në qytetin e Fierit dhe në vitet 1932-1940 kreu shkollën Teknike në Tiranë. U lidh me Lëvizjen Antifashiste, duke marrë pjesë në aksionet e njësitëve guerile të qytetit të Tiranës. Komiteti qarkor i Tiranës gjatë vitit 1943 e kishte ngarkuar me detyrat ushtarake. Në tetor 1943 u emërua komisar politik i Br. II S deri në maj 1944.

pensionoheshin në atë periudhë në moshën 55 vjeçare.

USHTARAKU MODEL ME PERFORMANCË DHE INTEGRITET TË LARTË INTELEKTUAL

Pas përfundimit të LANÇ-it, Maliq Sadushi vijoi shërbimin në ushtri si oficer, me detyra të ndryshme si, komandant batalioni në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve Tiranë, me studime të larta ushtarake në Akademinë Ushtarake "Frunze" në Moskë, në Brigadën e 5-të Këmbësorisë në Gjirokastrë, Shef shtabi brigade në Vlorë, komandant brigade në Laç, shef shtabi Divizioni në Shkodër, Shef shtabi Korpusi përsëri në Shkodër, student dhe pedagog në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu", i goditur në vitin 1973 kur u shkarkua padrejtësisht nga detyra e shefit të shtabit të korpusit, i rivlerësuar dhe emëruar me plotë të drejtë Zëvendësministër i Parë i Mbrojtjes, detyrë që e kreu deri sa Maliq Sadushin më 15.10.1982, e zuri "Fshesa e dytë e hekurt" ndaj kuadrove të larta të Ushtrisë Popullore. Por më saktë dhe qartësisht flasim urdhërat e emërimeve dhe shkarkimeve, më qartë flet dokumentacioni shtetëror. Në gjurmët arkivore të dokumentacionit për Gjeneralmajor Maliq Sadushin, në dosjen e tij ka dhjetra urdhëra që fillojnë në 1945 si Zv/komandant kompanie, komisar kompanie, Instruktor rinie, Shef seksioni sigurie, shef stërvitje batalioni, komandant batalioni special, me studime në Bashkim Sovjetik në Moskë në Akademinë Ushtarake "Frunxe", shef shtabi në Br20K, komandant Brigade, shef shtabi Korpusi, "Pedagog", në Akademinë Ushtarake "Mehmet Shehu", Zv/Ministër i Parë, në Ministrinë e Mbrojtjes, e deri më 1982 kur ka mbyllur karrierën 37 vjeçare ushtarake. K

a mbajtur gradat "Nëntoger" deri në "Gjeneralmajor", si shërbëtor i devotshëm i shtetit, si dhe është vlerësuar me dhjetra urdhëra, medalje e dekorata të luftës dhe të punës. Performanca intelektuale e Maliq Sadushit ishte nder për Vajzën, e Labërinë, ishte krenari, kur shkëlqente në të gjitha shkollat dhe akademitë më prestigjioze të kohës, edhe në Moskë. Nderimi, respekti dhe mirënjohja është për detyrat e shumta me rëndësi e përgjegjësi të madhe në ngritjen e Ushtrisë Popullore. Në studimet e

larta ushtarake nuk ishte thjeshtë një student, por hulumtues i thellë i artit ushtarak, një ushtarak me njohuri të spikatura teorike e profesionale, përfshi Kursin e Lartë Operativ në AU si shtabmadhor, si profesionist i dijeve ushtarake. Maliq Sadushi u formua si oficer i lartë, me gjykim të thellë, me mendime të pjekura për artin ushtarak popullor, për teorinë dhe shkencën ushtarake në përgjithësi, duke u vlerësuar nga kolegët, eprorët dhe vartësit si pjesë e korpusit të të urtëve të Ushtrisë sonë Popullore, që e përmbushën misionin e tyre në kushtet nga më komplekset e kohës. Në Labëri vlerësohet si burri që shkroi historinë me pushkë dhe me penë, pasi ka shkruar: Historiku i Vajzës (grup autorësh), si dhe librat: "Perlat Rexhepi" (2000), "Fshati ynë i mirë", (2002), "Nga brigjet e Jonit në malet e Sanxhakut", (2004), "Ata që nuk harrohen" (2005), "Mehmet Shehu, siç e kam njohur: kujtime" (2008). Ka qenë nismëtar për shpalljen e 12 dëshmorëve të rinj të finalizuar më 5.5.2025, si dhe nismëtar për ngritjen e bustit të poetit kombëtar Ali Asllani në Vajzë të Vlorës, dy amanete të përmbushur nga bijtë e bijat e fshatit Vajzë. Vëmendja ndaj Vajzës është sot amenet i të parëve dhe këtë amanet në breza e vijnë Nertili, Irfani, Sokoli, Mitati, Lushi, Arjani, Shkëlqimi, Nexhipi, Gazi, Çlirimi, Levzati, Xhevairi, Bedriu, Dritani, Admiri, Ziniu, kolonel Avni Bilbili, e qindra djem e vajza të tjerë të këtij fshati me rrënjë mëmëdhetare. Maliq Sadushi ishte dhe ngeli deri në fund të jetës bir i denjë i Labërisë, vlerë e urtësisë dhe mençurisë labe, që i njihte mirë zakonet e traditat, ishte atdhetar dhe luftëtar i përkushtuar i zhvillimit dhe vlerësimit figurave të shquara historike krahinore dhe kombëtare të zinin vendin e merituar. Ai ishte në çdo kohë pranë banorëve dhe fshatrave të Labërisë, kontribuoi për zhvillimin e tyre duke trokitur në dyert më të mëdha të shtetit, duke e dashur me zemër vendlindjen kërkonte përparimin e ekonomisë së kooperativave dhe ngritjen e mirëqenies së ekonomisë fshatare, kudo në Labëri. Në kujtesën e brezave Maliq Sadushi njihet si ushtaraku i lartë simbol i urtësisë, mençurisë dhe vlerave, që kontribuoi fuqishëm në ngritjen e Forcave të Armatosura shqiptare.

KUR BRIGADA E 3-të QËLLOI ME TOP ASAMBLËNË TRADHTARE

(Vijon nga faqja 9)

emërohet komandant i tankeve dhe gradohet gjeneralmajor. Në këtë post qëndroi deri ditën kur në vitin 1956, pas Konferencës së Tiranës, internohet në qytetin e Lushnjës dhe në vitin 1958 burgoset si kundërshtar politik i regjimit.

KOMISAR, SHAHIN RUKAJ

Shahin Rukaj, lindur më 4 prill 1918, në fshatin Matogji të rrethit Vlorë. Mësimet e para të fillores i mori në qytetin e Fierit dhe në vitet 1932-1940 kreu shkollën Teknike në Tiranë. U lidh me Lëvizjen Antifashiste, duke marrë pjesë në aksionet e njësitëve guerile të qytetit të Tiranës. Komiteti qarkor i Tiranës gjatë vitit 1943 e kishte ngarkuar me detyrat ushtarake. Në tetor 1943 u emërua komisar politik i Br. II S deri në maj 1944.

U emërua komisar politik i Br. XV S deri në çlirimin e vendit. Mbante gradën ushtarake Major. Në dhjetor 1944 emërohet në Ministrinë e Punëve Botore, inspektor. Në vitin 1946 u ngarkua me organizimin e administratës shtetërore të transportit automobilistik të Republikës. Kreu Universitetin e Moskës, në Fakultetin Ekonomi Politike në vitin 1960. Në vitet 1948-1982, ka kryer detyrën e zëvendësministrit të Ministrisë së Ndërtimit, të Ministrisë Miniera-Gjeologji etj. Ka qenë dhe përfaqësues i përhershëm në Këshillin Ekonomik të Ndihmës Reciproke (KNER) në Moskë dhe së fundi në aparatit të Këshillit të Ministrave, si këshilltar. Dekoruar me urdhra dhe medalje.

PROFILI

PROFESOR DR. HASAN ÇIPURI

TERMINOLOGU I SHQUAR USHTARAK

- Në vitin 2020, profesori, kolonel Hasan Çipuri, ka botuar në Prishtinë (bashkë me kolonel Kudret Mitën) veprën madhore “Fjalor Enciklopedik Usharak Shqiptar”, me format të madh, mbi 1000 faqe. Aty është tërë historia e madhe e ushtrisë shqiptare, e ngjarjeve të mëdha ushtarake, e personaliteteve ushtarake, e prijësve dhe e komandantëve, e luftëtarëve të shquar për liri e pavarësi. Aty është edhe gjeografia ushtarake...

Nga Prof. Dr. Hajri SHEHU

Prof. dr. Hasan Çipuri ka shkruar e botuar 32 560 faqe shtypi. Ka udhëhequr 24 vepra kolektive (fjalorë terminologjikë ushtarakë shqip-anglisht-rusisht etj.). 32 fjalorë shqip-gjuhë e huaj mbajnë emrin e Hasan Çipurit si autor, si bashkautor e si drejtues shkencor (kryeredaktor). Ka hartuar 160 zëra enciklopedikë. Ka shkruar 350 artikuj shkencorë e shkencorë-popullarizues. Ka përkthyer e botuar 14 libra historikë e ushtarakë. Ka drejtuar rreth 400 bashkëpunëtorë të jashtëm të Sektorit shkencor të Akademisë Ushtarake – tani, Akademia e Mbrojtjes. Ka hartuar e botuar 6 tekste mësimore universitare. Ka redaktuar 34 libra të fushave të ndryshme. Ka qenë pedagog në Universitetin e Tiranës e titullar i serbo-kroatishes. Ka folur e ka shkruar në pesë gjuhë të huaja. Ky ishte profesor Hasan Çipuri. Ky është shkencëtari me uniformë, - siç thotë kolegu i tij i nderuar, dr. Vangjel Kasapi, ish-shef i Sektorit shkencor të Akademisë Ushtarake. Ky ishte Hasani, anëtari i Institutit Biografik Amerikan (American Biographical Institute); “Personalitet ndërkombëtar i vitit” 2001 (Kembrixh, 2002), një ndër “2000 intelektualët e shquar të shekullit XXI” (Kembrixh, Angli, 2001); një ndër “Europeanët e shquar të shek. XXI” (Kembrixh, 2003); “Drejtor i përgjithshëm nderi për Europën” i Qendrës Biografike Ndërkombëtare (International Biographical Centre) të Kembrixhit, Angli.

54 VJET PUNË – NJË JETË NJERIU...


Në 54 vjet punë, profesor Hasan Çipuri ka pasur 12 detyra të rëndësishme funksionale. Nga 12 detyrat funksionale të profesor Hasanit, njëra ka qenë: Shef i Sektorit (më pas – Departament) të Terminologjisë dhe të Enciklopedisë Usharake në Akademinë Ushtarake, tani, Akademia e Mbrojtjes (1980-2002). Për punën vigane të Sektorit të Terminologjisë dhe të Enciklopedisë të Akademisë Ushtarake flasin Fjalorët e botuar dhe të gjithë librat e tjerë.

Profesor Hasani ka shkruar historinë e terminologjisë ushtarake të shqipes. Terminologjia është tërësia e termave të një fushe të shkencës, të teknikës etj.

Termi është fjalë a tog fjalësh për një koncept shkencor, teknik, ushtarak etj. Historia fillon me Rilindjen, vijon me Pavarësinë, me Ushtrinë Mbretërore, periudhën 1939-1944, periudhën pas Çlirimit e deri në kohët e sotme. Kjo terminologji ka qenë dhe është pjesë e rëndësishme e ushtrisë shqiptare, sepse siç dihet, ajo ka të bëjë me komunikimin ushtarak – aq i rëndësishëm në të gjitha kohët e në të gjitha momentet. Ajo ka qenë dhe është pjesë e rëndësishme e gjuhës sonë të përbashkët, jo vetëm se është ndër terminologjitë më të mëdha të shqipes (ushtria ka shumë shkenca, teknika, teknologji, armë, aparatura, pajisje etj. – çdo repart ushtarak ka armën e vet e teknikën e vet – e rrjedhimisht, edhe terminologjinë e vet), por edhe sepse përdorimi i dendur e thuasje i përditshëm i mjaft termave ka bërë që ata ta kalojnë kufirin e tyre (si term) e të përdoren edhe si leksik i përgjithshëm (le të themi, shënjestër, qitje, urë e varur etj.) në mjediset tona ushtarake, në stërvitjet ushtarake - më herët, edhe në fshat, në shkolla e në universitete. Gjuha është dukuri shoqërore, që do të thotë se ajo ekziston, ruhet e zhvillohet veçse në shoqëri. Por është edhe dukuri historike, sepse zhvillohet e pasurohet sipas zhvillimit të kësaj a të asaj bashkësie që e flet atë. Këtë ruajtje dhe këtë zhvillim na e përshfaq brenda parametrave të saj edhe monografia e profesor Hasanit për historinë e terminologjisë ushtarake të shqipes. Vetëm një shembull: Në Shtabin Madhor të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare u ngrit për herë të parë në historinë e Forcave tona të Armatosura një komision i terminologjisë ushtarake dhe togë, epror, këmbëz (e shkrepjes), siguresë, gatitull, qetësohul, eja në radhë! etj. janë krijuar nga ai komision. Shumë terma të tjerë si këta janë qemtuar, vjelë e pasqyruar në fjalorët terminologjikë ushtarakë e më së pari, në disertacionin e profesor Hasanit për doktoratë.

THEMELUES I TERMINOLOGJISË SË SOTME USHTARAKE TË SHQIPES

Profesor Hasani është themelues i terminologjisë së sotme ushtarake të shqipes, mbështetur fort mbi baza kombëtare e mbi parime krejt shkencore. Vetë profesor Hasani thotë: Terminologjia jonë ushtarake, tashmë është formuar e




funksionin si sistem. Janë diferencuar, qartësuar e saktësuar konceptet në përputhje me zhvillimin e mendimit dhe të praktikës ushtarake shqiptare. (Për konceptet në terminologji do të themi diçka më poshtë). Këtë thënie e vërtetësojnë një varg studimesh teorike në fushën e terminologjisë së shqipes e veçmas, të terminologjive ushtarake. Në terminologjinë ushtarake, ai që ka spikatur është profesor Hasani. Krahas studimeve teorike në fushën e terminologjisë në vitet '80 të shekullit të kaluar, në Akademinë Ushtarake (sot, Akademia e Mbrojtjes) filloi puna e organizuar shkencore për përpunimin sistemor, shqipërimin dhe kodifikimin tërësor të terminologjive tekniko-ushtarake. Ideatori dhe kryeorganizatori i kësaj pune kaq të gjerë ishte profesor Hasani. Për këtë qëllim u vol letërsia ushtarake (rregullore, tekste mësimore, udhëzues, revista e gazeta ushtarake e joushtarake etj.) nga Rilindja deri në ditët tona dhe u krijua një kartotekë terminologjike shkencore me rreth 200 000 skeda. Kartoteka është si puna e miellit të situat hollë, pa të cilin nuk mund të bësh gatesa të mira, ose si puna e arkivit, pa të cilin nuk mund të bësh histori. E gjithë kjo punë është bërë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen shkencore të profesor Hasanit. U krijuan komisione specialistësh ushtarakë e gjuhëtarësh. Edhe komisionet kishin në krye profesor Hasanin. Aty diskutohesh shkencërisht dhe vendosej për termin e caktuar. Unë kam pasur nderin dhe kënaqësinë të jem edhe bashkëpunëtor i jashtëm i Sektorit të fjalorëve të Akademisë Ushtarake në

ato vite. Gëlonin zyrat nga diskutimet. Shkruhej, punohej, skedohej, kërkohesh barasvlerësi në gjuhë të huaj (në parantezë: fjalorët ishin shumëgjuhësh, disagjuhësh ose dygjuhësh dhe gjuhë e parë ishte shqipja, sepse fjalori ishte për shqipen e për terminologjinë ushtarake shqipe). Ajo punë më ka lënë mbresa e dua ta përsëris thënien time: Sektori ishte si një Institut i dytë Gjuhësie. Falë lëndës së vjelë e organizimit të përsosur, u hartuan 25 fjalorë, me rreth 67 000 njësi terminologjike. Besojmë që pjesa më e madhe e tyre janë në dorë të përdoruesve. Shifrat nuk kanë nevojë për koment. Gjithë kësaj pune shkencore, kaq vëllimore, i ka paraprirë kryeredaktori i fjalorëve, profesor Hasani dhe studimi monografik, gjithashtu i profesor Hasanit: “Terminologjia ushtarake e shqipes” (botuar më pas / 1993 si libër më vete). Ja disa nga ata fjalorë: Fjalori i termave gjitharmësh, (1989) (hartuar nga një grup i gjerë ushtarakësh, specialistësh e gjuhëtarësh, nën drejtimin e profesor Hasanit. Aty bëhet përpunimi tërësor e sistemor i terminologjisë tekniko-ushtarake. Ai përfshin 11 000 terma); Fjalori i termave të topografisë ushtarake (shqip-anglisht-rusisht), 1985; Fjalori i termave të artilerisë (shqip-anglisht-rusisht), 1987; Fjalori i termave të zbulimit (shqip-anglisht-rusisht), 1989; Fjalori i termave të shërbimeve të prapavijës (shqip-anglisht-rusisht), 1987; Fjalori i termave të armatimit dhe të municioneve (shqip-anglisht-rusisht), 1989; Fjalori i termave të mbro-

(Vijon në faqen 13)

PROFILI



(Vijon nga faqja 12)

jtjes kundërajrore (shqip-anglisht-rusisht), 1990; Fjalor i termave të armës së xhenios (shqip-anglisht-rusisht), 1990; Fjalor i termave të armës së tankeve (shqip-anglisht-rusisht), 1990; Fjalor i termave ushtarakë të NATO-s, 1997; Fjalor i shkurtesave dhe i akronimeve të NATO-s (anglisht-frëngjisht-italisht-gjermanisht-shqip), 1999; Fjalor i termave të ndërlidhjes (shqip-anglisht-rusisht), 2000; Fjalor i detarisë (anglisht-shqip), 2000. Një punë, vërtet vigane. Kryeredaktor - profesor Hasan Çipuri. Profesor Hasan Çipuri ka hartuar vetmorisht edhe dy fjalorë të mëdhenj terminologjikë ushtarakë (me 20 000 terma), botuar më 1990 dhe 1993 – “Fjalor ushtarak serbokroatisht-shqip” dhe “Fjalor ushtarak italisht-shqip” dhe një Fjalor të përgjithshëm shqip-serbisht (me rreth 45 000 fjalë dhe me mbi 25 000 shprehje e frazeologjizma”, 2008.

BASHKËAUTOR I VEPRËS “FJALOR ENCIKLOPEDIK USHTARAK SHQIPTAR”

Në vitin 2020, profesori, kolonel Hasan Çipuri, ka botuar në Prishtinë (bashkë me kolonel Kudret Mitën) veprën madhore “Fjalor Enciklopedik Ushtarak Shqiptar”, me format të madh, mbi 1000 faqe. Aty është tërë historia e madhe e ushtrisë shqiptare, e ngjarjeve të mëdha ushtarake, e personaliteteve ushtarake, e prijësve dhe e komandantëve, e luftëtarëve të shquar për liri e pavarësi. Aty është edhe gjeografia ushtarake. Edhe sistemi i armatimit dhe i teknikës ushtarake. E tërë kjo punë gjigante mjaftonte që profesor Hasani të siguronte një

emër shumë të nderuar në shkencën shqiptare: si gjuhëtar, si terminolog, si terminograf, si leksikolog e si leksikograf i pazëvendësueshëm. Por profesori nuk mund të mjaftojë vetëm me kaq.

Recensionet për fjalorë të të tjerëve e oponencat për mbrojtje doktoratash, përkthimet e puna mësimore universitare si titullar i lëndës “Gjuha serbokroate” në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Tiranë i kanë kërkuar kohë, por, gjithsesi, kanë qenë veprimtari shumë e dashur për profesor Hasanin dhe shumë e vlerësuar nga të tjerët. Por as me kaq nuk është mjaftuar profesor Hasani. Ai ka shkruar dhe botuar disa artikuj për terminologë ushtarakë - Skënderbeun, Aleksandrin e Madh, Napoleon Bonapartin, Xhingis Khanin, Zhukovin etj. Këta janë qershia mbi tortë.

Ushtria ka shumë armë, shërbime e specialitete; rrjedhimisht, ka edhe shumë terminologji e shumë terma. Ka terma të teknikës e të strategjisë, të organizimit e të drejtimit të trupave, të teknikës së armatimit, të shërbimeve e të strukturës së forcave të armatosura. Ushtria ka edhe terma politiko-ushtarakë e historiko-ushtarakë. E, edhe terma të tjerë. Dhe nuk është e lehtë të veçosh e të pranosh aksh term kur ai shënon realitë të disa armëve, shërbimeve e specialiteteve. Pra, nuk është e lehtë të përcaktosh vëllimin e konceptit dhe vëllimin e termit sipas tiparit të ngushtë tematik. Nuk është e lehtë të dallosh e të veçosh as leksikun e përgjithshëm ushtarak nga leksiku ushtarak special. Ka edhe shumë koncepte që lidhen tërthorazi me ushtrinë. Kjo do të thotë, më në fund që nuk ka qenë e lehtë të bëjë inventari i termave

PROFESOR DR. HASAN ÇIPURI TERMINOLOGU I SHQUAR USHTARAK

teknikë, shkencorë etj. dhe brenda kësaj kornize të ruhej simetria e fjalorëve. Por në gjithë atë punë është bërë një sintezë e përgjithshme e terminologjive ushtarake të shqipes dhe janë harmonizuar fusha e nënfusha të saj të veçanta dhe me kënaqësi kemi vërejtur se zgjedhja dhe përzgjedhja e termave është bërë siç duhet dhe është ruajtur simetria në fjalorë.

Siç do ta sqarojmë pak më tej, terminologët, në vend që të nisen nga fjalët për të hetuar kuptimet, nisen nga përkufizimet e koncepteve për të gjetur fjalët (= termat), që i emërtojnë ato. Por shkenca e teknika ecin e zhvillohen shpejt. Atëherë, një fjalor terminologjik i kësaj a i asaj dege të shkencës a të teknikës duhet të jetë bashkëkohor edhe në koncepte, edhe në fjalë (= terma); ndryshe, konsiderohet i vjetruar e i pavlefshëm. Fjalorët terminologjikë, me kryeredaktor profesor Hasan Çipurin kanë qenë gjithnjë të kohës. Edhe konceptet, edhe termat kanë qenë të besueshëm, sepse kanë ardhur nga burime të shkruara bashkëkohore - rregullore, tekste mësimore, broshura, artikuj etj. (shih, p.sh., ndërlidhje videotelefonike, tank urahedhës, bombë neutronike etj.). Kësisoj, fjalorët kanë qenë për çdo dije ushtarake, tekniko-ushtarake e tekniko-shkencore, madje, edhe për njëfarë profesionalizimi të punës së ushtarakut. Në parantezë: Nëse do të dish, p.sh., për aerodromet dhe llojet e aeroplanëve, shko te Fjalori i termave të mbrojtjes kundërajrore.

Fjalorët ishin kryesisht shqip-gjuhë të huaja. Kësisoj, ata ishin fjalorë ndërkombëtarë. Gjuha shqipe përballej me gjuhë të mëdha të lëvruara. Dhe në këtë përballeje ajo ka qenë e suksesshme. Por ne duam të dalim diku tjetër. Lexuesit mund t'i shkojë në mendje që në këtë lloj pune kemi të bëjmë me përkthim. Jo, nuk kemi të bëjmë me përkthim. Në terminologji barasvlerësi (ekuivalenti) në gjuhë të huaj (ose anasjelltas, në gjuhën shqipe, kur fjalori është gjuhë e huaj - shqip) nuk përkthehet. Edhe përkthimi - nëse dikush do ta quante përkthim - nuk është transferim fjale, por transferim koncepti. Barasvlerësi terminologjik është “përkthim” koncepti e pastaj gjetje e termit (fjalës) - një punë fort e vështirë. Atëherë, dija për degën e shkencës a të teknikës, dija për temën, dija për gjuhën amtare e dija për gjuhën e huaj na japin një fjalor terminologjik të kënaqshëm. Falë formimit të tij ushtarak, shkencor e intelektual dhe njohjes së shkëlqyer të shumë gjuhëve të huaja (anglisht, rusisht, italisht, serbisht, kroatish etj.), profesor Hasani e zgjidhte një gjerdiane, kur aksh komision terminologjik ngecte diku.

Në gjuhën shqipe, siç dihet, ka gjithnjë proces krijues dhe risimtar në punë të fjalëkrijimit e të fjalëformimit, sidomos në gjuhën e shkencës dhe të teknikës. Pra, në terminologji mund të krijohen fjalë të reja. Por me kusht që: a) ta japin të saktë konceptin a nocionin; b) të jenë krijuar sipas rregullave e gjedheve fjalëformuese të shqipes. Autoritetin për të krijuar e pranuar një term të ri e kanë më së pari terminologu e specialisti. Por nuk mjafton krijimi i termit të ri. Duhet një strategji që të sigurojë vlerësimin dhe pranimin e aksh risie dhe në përgjithësi, zhvillimin e gjuhës speciale të aksh dege

të shkencës, teknikës etj. Kjo strategji është ndërtuar edhe me fjalorë të tillë terminologjikë ushtarakë. Me kënaqësi kemi vërejtur që në këtë strategji, përpjekja e profesor Hasanit dhe e komisioneve terminologjike, të drejtuara prej tij, për ta pasuruar gjuhën shqipe me fjalë të reja e për ta ruajtur të pastër gjuhën shqipe, duke shmangur fjalë të huaja të panevojshme, ka qenë e vjueshme dhe e suksesshme. Shih, p.sh., rrugështruese, urdhërveprim, gjurmëti, ujëvëçues, pikëlidhje, dritëmatës, vetërregullues etj. Në to mund të shihet fare qartë modeli i shqipes, çka i bën më të pranueshme (siç ka, p.sh., shenjëtari, ka edhe helmueshmëri, siç ka i kapshëm, ka edhe i mbartshëm etj.). Çndotje dhe çndotës janë formime shqipe të profesor Hasanit. Janë gjurmuar dhe gjetur terma edhe me formim popullor (tipi kushtrim, shpatinë dyjare, aeroplan bukël etj.), duke synuar kështu demokratizimin e mëtejshëm të terminologjive shqipe ushtarake e të vetë ligjërimit ushtarak.

Gjuhët marrin e japin. Gjuhët marrin për të plotësuar ndonjë qelizë të zbrazët në strukturën e tyre. Gjuhët marrin fjalë ndërkombëtare (ndërkombëtarizma). Gjuhët nuk marrin fjalë të huaja të panevojshme, ose fjalë a formime me prejardhje të huaj, gjithashtu, të panevojshme, që bëhen si rriqra në trupin e saj të shëndoshë. Prandaj profesor Hasan Çipuri nuk i do fjalët bocman, defensivë, dislokim, eksploziv, paramilitar, oksidim, plasdarm etj. Prandaj ai kërkon shenjëtar e jo snajper, pamor e jo vizual, dyluftim e jo duel, denduri e jo frekuencë, nxënësi e jo kapacitet, njehsim e jo kalkulim, qëndresë e jo rezistencë, nismë e jo iniciativë. Prandaj profesor Hasani ka shkruar rreth 20 artikuj për shqipërimin e shumë termave ushtarakë.

Të gjithë fjalorët terminologjikë synojnë të jenë normativë, sepse e kanë për detyrë të japin termin që duhet përdorur. Kjo do të thotë që ata e ndihmojnë përdoruesin të zgjedhë atë term a togfjalësh terminologjik që e ka pranuar (ose që mund ta pranojë) gjuha shqipe standarde. Fjalorët e autorit, bashkautorit dhe kryeredaktorit Hasan Çipuri janë normativë në të gjitha elementet e në të gjithë treguesit. Të tillë janë edhe barasvlerësit e gjetur në gjuhë të huaj. Në këtë mënyrë, përdoruesit i jepet mundësia edhe të lexojë, edhe të përkthejë literaturë të huaj.

Terminologjia ushtarake pasqyron zhvillimet që kanë ndodhur a që ndodhin në fushën e mbrojtjes në kushte të caktuara ekonomiko-shoqërore e politike. Ajo pasqyron shkallën e modernizimit të Forcave të Armatosura. Prandaj sot, puna me terminologjinë ushtarake, - vëren profesor Hasani, - nuk duhet konsideruar e përfunduar. Edhe pse ajo po merr karakter të qëndrueshëm, ka raste luhatjeje e mosnjësimi. Por, siç dihet, luhatjet në fushën ushtarake janë me pasoja. Prandaj, me të drejtë profesor Hasani sugjeron të ndiqet terminologjia ushtarake e NATO-s, pjesë e së cilës jemi edhe ne, për ta përfshirë atë në fjalorët terminologjikë ushtarakë përkatës. Sepse standardizimi i koncepteve (brenda NATO-s) sjell edhe standardizimin e termave ushtarakë e të terminologjive ushtarake.

ANALIZË

Rreth librit “Shpifjet e Kadaresë nuk e ndryshojnë të vërtetën”


ABSURDI I PASKVILEVE TË

SHPENDI TOPOLLAJ

Kur u njoha me librin e Kapllan Resultit, (Buroviç, dhe që së fundi, duke iu referuar origjinës së tij, kishte zgjedhur të quhej Resulbegoviç), me titullin “Fytyra e vërtetë e Kadaresë”, dhe pashë se veç mllfeve, aty nuk kishte asgjë të vërtetë, më lindi ideja të shkruaja diçka rreth tij, gjithmonë si një polemikë korrekte. Por duke menduar se Ismaili nuk kishte fare nevojë për apologjinë time, pasi edhe masa e madhe e dinte kush qe, dhe nga ana tjetër, ajo mund të tingëllonte disi si tundje e puplave të freskut, por edhe se dikush që e njihje më tha se autori i atij libri, edhe pse nuk të ka parë ndonjëherë, do të të qepet me bukë në trastë, vendosa të shoh punën time. Nuk vonoi dhe me një inat të pashuar, Resulbegoviçi, shkroi dhe botoi librin tjetër “Shpifjet e Kadaresë nuk e ndryshojnë të vërtetën”, ku inati kishte kaluar në shkrimin e një urrejtjeje të pafre ndaj atij shkrimtari gjenial, me të cilin krenohet e gjithë Shqipëria. Tani që ai nuk është më mes nesh, mendova se është detyrë e kujtdo, të mbrojë nderin e kolosit që me veprën e tij të pavdekshme, u bë përfaqësuesi më dinjitoz i vlerave të popullit tonë, për të mos thënë, etaloni i konstitucionit shpirtëror të shqiptarëve. Pastaj, edhe i ndjeri Kapllan kishte ndërruar jetë, dhe nuk druhesha se nuk do të më ndahej me atë trastën e tij. E dija se Kapllani ishte një emër i njohur qysh kur doli romani i tij “Tradhtia” në vitin 1962. Por, si shumë të tjerëve, nuk i qe ndarë dhe atij fati i keq, pasi veç burgut në Idrizovë gjatë regjimit të Titos, krejt padrejtësisht qe dënuar edhe te ne, ku kishte ardhur, me nja njëzet vjet. Aso kohe, arsyeja e dënimit nuk ishte shumë e qartë, por fakti është se ishte një i burgosur politik dhe si u mësua më vonë, atje ku e kishin mbyllur në hekura, kishte mbajtur qëndrim burror. Si kreu dënimit, dhe pa se këtu ishte fashitur vëmendja dhe nderimi për të, iku dhe u vendos në Zvicër, ku asnjëherë nuk e humbi interesin për Shqipërinë dhe shqiptarët. Me një gjendje të trazuar psikologjike, shpesh manifestonte edhe mllfe ndaj nesh, duke na akuzuar kryesisht si popull mosmirënjohës. Veç më dukej se harronte që fajin për ato vuajtje që hoqi, nuk ja kishin njerëzit e thjeshtë, por Enver Hoxha me sistemin gjakatar që ndërtoi. Kuptohet që e kishte të qartë se komunizmi shqiptar, ashtu si ai jugosllav, kishte devijuar deri atje, sa, sikurse shprehet, edhe vetë Marksini po të vinte këtu, do ta burgoste. Ai e quante veten internationalist, që e thënë shqip, donte të thosh, komunist i vërtetë. Dhe ky “komunist i vërtetë” kishte zbuluar se bashkëpunëtori më i afërt i Enverit, ishte Ismail Kadareja. Dhe për të arritur në këtë përfundim, kishte mjaftuar një deklaratë e këtij të fundit, në një intervistë televizive, ku paskej thënë: “Vite më parë është botuar një libër... kundër meje.

E NJIHNI NJË NJERI QESHARAK ME EMRIN KAPLLAN RESULI?

Them qesharak, sepse ky njeri, pasi harxhoi gjysmën e jetës duke u ankuar se u persekutua prej serbëve nga që është shqiptar, tani po e harxhon gjysmën që i ka mbetur, duke u ankuar për të kundërtën. Domethënë se u persekutua prej shqiptarëve nga që është serb. Ajo që të habit në fatin e këtij shkrimtari është fakti se pas daljes nga burgu i gjatë, nuk pati dëshirë të dëshmojë as për torturat, xhelatët, diktaturën komuniste, në thonjtë e së cilës vuajti kaq kohë, por u ul të shkruajë libër kundër kolegut të tij I. Kadare. Thuajse e keqja e Shqipërisë, paskësh qenë ky shkrimtar. Thuajse kësaj Shqipërie kaq të përsosur, shkrimtari I.K. ia prishte shkëlqimin. Me këtë tregoi se ky I.K. paskish qenë tortura e tij, ferri dhe tirani që e shtypte. Por historia nuk mbaron me kaq. Pasi e pa se nuk e



përmbysi dot “diktatorin”, domethënë nuk e nxorri dot nga letërsia shqipe, bëri gjestin e fundit të dëshpëruar: doli vetë nga kjo letërsi, madje doli nga gjuha shqipe, madje edhe më keq, doli edhe nga kombi shqiptar, u vetëshpall serb e nisi të shkruajë serbisht”. Në vazhdim, të gjithë këtë, Kadareja e quan smirë të lemerishme të shkrimtarëve të vegjël në Ballkan. Këtu mund të ketë ndonjë teprim a pasaktësi, revoltë ndaj akuzave të padrejta që Kapllani ka bërë ndaj Kadaresë, por kaq është dashur që hercegnovasi, të shkruajë librin në fjalë. Afërmendësh që në deklaratën e Kadaresë ndihej një farë pasioni, jo vetëm se ai ishte prekur nga tërbimi i Kapllanit me të, por edhe e pakët ishte shkalla e njohjes që ai kishte. Ai kishte dekada që thuajse ishte harruar; pastaj edhe vetë nuk kishte arritur të sqaronte përkatësinë e tij. Edhe kur ishte i lirë, Kadareja nuk kishte pasur as ndonjë miqësi e as ndonjë njohje me të. Pastaj, çfarë kishte në dorë Kadareja, kur e nuhaste qartazi se edhe vetë ishte i survejuar nga të katër anët, gjë e vërtetuar me dokumente të shumta në dy volume, nga i mirënjohuri gazetar Dashnor Kaloçi (“Denoncimi i Kadaresë” dhe “101 dokumente të sigurimit kundër Kadaresë”). I qenë turrur për romanin “Dimri i Madh”, e më tej, çfarë nuk i punuan, si për “Pashallarët e Kuq”, ashtu dhe në atë Plenumin e famshëm të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve për “Pallatin e Ëndrrave”, ku aludimet i kuptonte edhe një gjimnazist i zakonshëm. Por, le të kthehemi te libri. Shihni se çfarë thotë Kapllan Resulbegoviçi për Kadarenë: “Askush nuk i indokrinoi shqiptarët me enverizëm si dhe sa ai, mbrenda dhe jashta kufijve të Shqipërisë, në vrrin e malsi, dijasporë e kudo”. “...bashkëpunoi dhe me Sigurimin... tua provokue njerëzit anë e mbanë Shqipërisë dhe jashta kufijve, tue i dërgue Sigurimit raporte me të dhana të vërteta dhe shpifje e intriga ma monstruoze herë kundra këtij e herë kundra atij, të cilat i firmoste me pseudonimin GJENERALI”. “Ismail Kadareja ulurinte në surdinë me E. Hoxhën: Të burgosurit e Burrelit duhen tredhur!”. “...prej Parisit na u mburr se na paska qenë disident dhe kundërshtari Nr.1 i E. Hoxhës”. “...banda e Kadaresë ose i ka detyrue me m'i mbyllë dyert e botimit, ose, në qoftë se nuk u janë bindë, i kanë mbyllë e ma nuk dalin ato organe”. “Nuk ka asnjë dyshim se në këtë veprimtari kundra meje ka marrë pjesë edhe Kadareja... edhe tashti, mbasi dola pej burgut. Jo vetëm pse nuk don afirmimin tim në botë, por edhe pse e din se me këtë afirmim njëkohësisht bahet edhe demaskimi i Enver Hoxhës...”. “Kadareja më ka akuzue dhe vazhdon me më akuzue edhe se gjoja dola nga kombi shqiptar. Ai për këtë gjë edhe më ka arrestue. Më ka dënue për agitacion e propagandë me dhetë vite burg ma monstruoze (mbi ato 30 e kusur që kishal)”. “...vetë shqiptarët që i kundërvi-

hen, i quen PROSTITUTË INTELEKTUALE”. “Kosovari Nazmi Berisha e ka pranue botnisht, përmes shtypit, se i kam shpëtue jetën nën thundrën e Kadaresë”. “Përmes klarkëve apo dollarëve të trafikantëve shqiptarë të drogës dhe piramidave mashtruese u batë edhe akademik i Akademisë Franceze të Shkencave Amoralë dhe Gënjeshtrave Politike!”. “Keni ba dhe po bani përpjekje që as ndërmarrjet botuese (bile as shtypshkronjat që i pagoj unë!), jashta kufijve të Shqipërisë të mos më botojnë gjë”. “Deri më sot ju Kadare nuk keni shkruar as një të qindën e asaj që kam shkruar unë kundër enverizmit, që të mos them se nuk keni shkruar asgjë: edhe në qoftë se aty - këtu keni shprehë me aluzione, edhe mbas “arratisjes” në Francë(!), ndonji fjalë, çdo gjë e keni ba në bazë të instrukcioneve që keni marrë e merrni nga shtabi enverist, me qëllim që t'i paraqiteni botës si antienverist, se mos ua jep Çmimin Nobel”. “Kur shqiptarët e sflitun nga terrori juej... sulmuan ambasadat e huaja për me gjetë shpëtim atje, ju i quejtët ESKREMENTI I KOMBIT”. “...ikët nga populli i revoltuem me terrorin tuej, me krimet e maskarallëqet tueja që nuk kanë të përshkruem. Ikët që të mos ju shklyente”. “Ju Kadare jeni ai që më keni përjashtue nga Lidhja e Shkrimtarëve të Shqipërisë...”. “... po e them se jeni përpjekë me ma pushue edhe gruen nga puna në arsimin sviceran... bile me më përjashtue edhe mue nga Zvicra!”. “E kahmotshme dhe ma e thellë asht urrejtja e Kadaresë kundra kosovarve”. “Më keni rjepë për së gjalli, o bandit, që shtiresh për shkrimtar e akademik!”. “...jeni egoist, meskin, kontravers, i pabesë etj. se qëndrimi juej asht nën nivelin e moralit qytetar, se jeni qesharak dhe patologjik...”. “Po ju Kadare kurrë nuk keni qenë dhe as që keni me qenë njeri. Keni qenë dhe keni mbetë PËRBINDËSH. Ndaj edhe ju kanë urrejtë dhe ju urrejnë edhe kolegët tuej, populli juej”. “...në qoftë se edhe vetë Kadareja, direkt apo indirekt, nuk asht në lidhje ma të ngushtë me këto piramida mashtruese, plaçkitëse, banditeske?!”. Pra, Kadareja paskej qenë i lidhur edhe me Sudan. “Kush u dha rushvet francezëve që ta shpallnin Kadarenë akademik?”. “(I.K.) barabai me ma precedan jo vetëm në historinë e popullit shqiptar, por edhe të njerëzimit”.

E MORËT VESH O NJERËZ, SE DERI KU ARRIN MARRIA

E morët vesh o njerëz, se deri ku arrin marria: ai burrë që e ka nderuar dhe bërë krenar popullin tonë, ai shkrimtar gjenial që është kandiduar për çmimin Nobel, aq herë sa nuk mbahen mend, ai shqiptari i madh që e kanë nderuar e dekoruar Presidentët e vendeve që i kanë dhënë aq shumë historisë dhe kulturës botërore, ai njeri që do t'i përkulemi në jetë të jetëve me veneracion, qenka turpi i njerëzimit. Kushdo që njihet me këto cilësime të këtij autori të pazakontë,

ANALIZË

KAPLLAN RESULIT PËR KADARENË



pasi vë buzën në gaz, nuk ka sesi të mos i lindë pyetja: Po përse i turret me këtë egërsi Kapllan Resuli, ky lunatik (lat. lunaticus), Kadaresë, përse lëshon gjithë këtë vrer ndaj tij, përse kërkon tek e fundit ta denigrojë atë në sytë e opinionit të gjerë? Dhe po duke e lexuar librin e tij ose më drejtë, paskvilin e tij, del vetiu edhe përgjigja: nuk kemi të bëjmë me një njeri që çrregullimet mendore ia kushtëzoi hëna me fazat e saj, por një megaloman, me dëshirë për të zenë vend nderi në letërsi jo natyrshëm, por me imponim. Dhe nuk ka gjetje më interesante dhe të rafinuar, se sa të dalësh mbi ujë, duke “mbytur” tjetrin, e ca më shumë, kur ky tjetri është i madhi Ismail Kadare. Virgjili diku ka thënë (më duket tek “Eneida”): “Furor arma ministrat” që do të thotë se zemërimi ose tërbimi zgjedh armët. Ai e ka fjalën për atë që në dëshpërim e sipër, përdor çfarëdo lloj arme për mbrojtje. Por Kapllan Resuli, nuk ka zgjedhur armën e ndershme për t’u mbrojtur. Madje, ai as ka zgjedhur njeriun e duhur, e ca më shumë se ky njeri nuk i detyrohet për asgjë atij dhe nuk ka përse të mbrohet prej tij. Në historinë e letërsisë nuk kanë munguar kurrë polemikat, madje edhe akuzat keqdashëse mes shkrimtarëve. Por ato kanë qenë brenda arsyes dhe edukatës, të cilën Sokrati e quante një zjarr shëndritës. Kapllan Resuli pretendon se është luftuar ngaqë i ka zënë rrugën dhe vazhdon t’ia zerë, Ismail Kadaresë. Ma do mendja se edhe vetë ai nuk e beson këtë. Dhe për ta bërë bindëse këtë pretendim, nuk vlejnë as broçkullat që thotë për të: “Përse ky frikacak e sahanlëpirës i të gjithëve që kanë ardhë në pushtet në Shqipëri, ky bandit e kriminel nga më të poshtrit, që i këndon hosana E. Hoxhës dhe qenit të tij, ankohet se qenkam unë (e jo ai), që nuk e demaskon E. Hoxhën e bandën e tij?! Aq shumë i hiqka shpirti këtij hipokriti për demaskimin e asaj bande?! Po ai penën në dorë e ka. Pse nuk e ban vetë atë gja?! A nuk kemi të bajmë me një maskara që në maskarallëkun e tij nuk din të ndalet?!” Mirëpo, Kapllani me sofizmat e tij, dashje pa dashje kundërshton edhe veten, kur pikërisht prej këtij “maskarai” e “hipokriti” kërkon: “...Kadareja iku nga sytë kambët, iku siç ikin minjtë nga gjemija që mbytet. E la popullin vetëm në momentin ma kritik, kur duhej

të sulmonte kështjellën e diktaturës, kur duhej me u kacafytë me sambistat e terrorit...”. Njerëz! Këtu mbajeni të qeshurën; e përfytyroni Ismail Kadarenë duke u kacafytur me sambistat e terrorit? Ai kishte shkruar për marrje kështjellash, por askush nuk priste që edhe vetë Kadareja, i brishtë siç qe, të mund t’u qepez mureve të tyre e të ngjitej mbi bedena, për të ngulur flamurin e demokracisë. E çuditshme është se pasi e quan në faqen 50, Kadarenë “bizantin keni qenë dhe keni mbetë! Enver Hoxha asht i pari dhe ju, Kadare, zeni vendin e dytë, menjherë mbas tij...”, Kapllan Resuli na rrëfen përpjekjet që paska bërë për t’u afruar me të. Për rrjedhojë, i bije që gjersa i shtrin dorën bizantin Nr. 2, pa tjetër që do të synonte edhe pajtimin me bizantin Nr. 1, pra me vetë Enverin. Ja si shkruan ai: “Sikur ju Kadare... të mos më kishit provokue me një duzinë shpifësh e intrigash ma të ndyta përmes shtypit, unë kurrë nuk do ta kisha shkruar atë libër (e ka fjalën për “Fytyra e vërtetë e Kadaresë”, shën. im), ashtu siç nuk do ta kisha shkruar as këtë. Përkundrazi, ju e dini shumë mire se, sapo dola prej burgut, ju shtriva dorën e “pajtimit”, se tue e dijtë që jeni agjent i Sigurimit dhe personalisht i Ramiz Alisë me Nexhmije Hoxhën, mendova me ju inkuadrue në frontin kundra enverizmit”. Por Ismaili nuk paska pranuar. Pra, më thoni tani, si kuptohet e gjithë kjo, veçse si hakmarrje primitive ndaj Kadaresë, por sikurse del në libër, edhe si dredhi për të zenë një vend akoma më nderuar në hierarkinë e letrave shqipe. Kapllani e shpreh hapur këtë: “Asht një fakt i pamohueshëm se shkrimtarët shqiptarë sot e kësaj dite as nuk e kanë shkruar dhe as që janë të aftë me e shkruar një roman si TRADHTIJA. Do të duhen dekada (që të mos them shekuj), që ata të arijnë atë zhvillim ideo - shoqnor dhe ta paraqesin realitetin e Shqipërisë në atë mynyrë siç e paraqita unë në romanin tim realitetin e Jugosllavisë”. Me sa duket, ky autor, i larguar nga Shqipëria, nuk e ka idenë se ç’është shkruar nga dhjetra autorë për ç’ka hoqën hetuesirave, burgjeve e internimeve, nuk e di se librat e tyre për demaskimin e krimeve të komunizmit, janë të denja për të fituar çdo çmim prestigjioz ndërkombëtar, por nuk është njohur as

me librat e botuara nga vetë Kadareja rreth këtyre temave, sikurse mohon pa të drejtë, gjithë çka bërë Kadareja për çështjen e Kosovës dhe të drejtave të popullit kosovar. Vetë ai e ka akuzuar në librin e tij Ismailin si nacionalist, gjë që bije ndesh me akuzën se ai ka qenë kundra kosovarëve, që i paska urryer ata dhe ka kurdisur së bashku me serbët, pogrome ndaj tyre (fq.46). Kjo, mendoj se është e turpshme, sikur ta thonë edhe qarqet më të egra shoveniste serbe. Kapllani pohon se Kadareja e ka quajtur martir të dy burgjeve, atij në Jugosllavi dhe atij të tmerrshmit, në Shqipëri, dhe ky cilësim është plotësisht i merituar për të. Asnjëherë nuk ia ka mohuar as talentin dhe as kontributin e tij letrar. Askush nuk e qorton atë për romanin që i dha emër “Tradhtia”, poemën “Bojana”, tregimin “PLEH” apo sonetin “Do të vij”. Madje do të shtoja se është e padrejtë që në enciklopeditë tona, nuk ka një zë për Kapllan Resulin. Por për këtë, fajin nuk e ka Kadareja i cili kurrë nuk ka bërë pjesë në komisionet për përpilimin e Enciklopedisë tonë. Prandaj duket krejt absurde kur lexon në libër se Kapllani, nuk ngurron t’u drejtohet shqiptarëve për Ismail Kadarenë, instruktorit dhe AGENS SPIRITUS: “vazhdoni me e çmue, me e dashtë, nderue e me e ndihmue Kadarenë (dhe shton, shën. im), kurse për mue rezervoni nënvleftësimin dhe injorimin, rezervoni urrejtjen tuej dhe luftën ma të egër dhe ma pa princip, se jam antienverist dhe, me origjinë, jam nga Hercegovina e Boka, pinjoll i të famshmit kont Jozo Buroviq”. Por, edhe kjo bije në kundërshtim me çfarë ka deklaruar në faqen 49, ku shkruan: “Vetë populli shqiptar më quejti hero e Mandela i Shqipërisë”. Më tej Kapllani, tregohet dinak dhe duke dashur të intimidojë shqiptarët, si trima e të guximshëm, bën thirrje që t’ia çjerrin maskën “kriminelit” Kadare, pasi ai po i merr nëpër këmbë dinjitetin, paçka se ai është “Nderi i Kombit” tonë. Kështu që nuk na mbetet tjetër, veçse të themi se asnjë shpifje apo akuzë keqdashëse, nuk mund ta përlyejë figurën e pastër prej atdhetari të shquar të gjenit Ismail Kadare. Dhe kushdo që kërkon të baltosë me të pavërteta atë, duhet të kujtojë fjalët e arta të Charles Colton - it se “Shpifja dëmton më shumë atë që shpif, se atë ndaj të cilit shpifet”.

FOTOREPORTAZH

TATJANA ÇARKAXHIU (PARLLAKU) NË TRIBUNËN E TAKIMIT PËRKUJTIMOR NË 83 VJETORIN E KONFERENCËS SË PEZËS



- Në emër të Organizatës së Bashkuar të Veteraneve të LANÇ dhe pasardhësve, kryetarja e kësaj organizate Tatjana Çarkaxhiu Parllaku dhe anëtari i Kryesisë së OBVLP, veterani 91-vjeçar Shuaip Methasani vendosën një kurorë me lule pranë memorialit të Konferencës në Pezë, në shenjë respekti dhe nderimi për të gjithë ata që kontribuuan në këtë moment historik për vendin...



OPINION

KEMI HARRU ME QESHË!

Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

(Vijon nga fq. 1)

Shqipëria po vuan braktisjen masive të fshatrave, nga Jugu në Veri dhe përballet me një krizë të thellë demografike, që nëse nuk frenohet

het me politika të guximshme dhe të menjëhershme, mund të çojë në kolaps jo vetëm tregun e punës dhe ekonominë, por edhe vetë ekzistencën e një shteti funksional.

E thënë thjesht: vendi e ka punën pisk nëse rënia e numrit të popullsisë vijon me këto ritme.

Edhe ata pak të rinj (apo edhe burra) që kanë mbetur tek tuk në shtëpitë e ndonjë fshati, si këtu në Pezë të Madhe, ndërsa në emigracion kryejnë punë nga më të rëndomtmat, këtu në vendin tonë të bekuar nga Zoti për resurset natyrore, hezitojnë të punojnë.

E thënë troç: Punë ka por mungojnë punëtorët!

Të dhënat më të fundit nga INSTAT dhe Eurostat janë alarmante. Popullsia në grupmoshën 0–29 vjeç është tkurrur me 44% në vetëm një dekadë, ndërsa ritmi i emigracionit të të rinjve është përsheptuar në nivelet më të larta që nga vitet '90.

Nëse ky trend vazhdon, Shqipëria do të ketë më pak se 1 milion banorë deri në vitin 2100, një shifër që e zhvesh vendin nga kapaciteti për zhvillim ekonomik, mbrojtje sociale dhe qëndrueshmëri kombëtare.

“Monitor” raporton se në harkun kohor 2011–2024, numri i të rinjve shqiptarë ka rënë nga 1.36 milionë në vetëm 764 mijë. Njëkohësisht, emigracioni neto është

dyfishuar pas pandemisë, me mbi 43 mijë të larguar në 2023. Rreth 80% e tyre janë të rinj në moshë pune. Studentë ekselentë, mjekë, inxhinierë dhe zejtarë po lënë vendin për shanse më të mira në Perëndim.

Kjo po krijon një vakum të madh në tregun e punës. Bizneset raportojnë mungesë kandidatësh të kualifikuar dhe të pakualifikuar. Në bujqësi, mbi gjysma e të punësuarve janë mbi 50 vjeç. Në ndërtim, turizëm, tregti dhe shërbime, mungesa e fuqisë punëtore është kthyer në problem struktural.

Kriza demografike nuk është vetëm çështje popullore, por një bombë sociale me sahat. Shpopullimi i Shqipërisë është një nga sfidat më të mëdha të shekullit në të cilin jetojmë.

Në këto kushte, u ka ngrirë buzëqeshja, sipërmarrësve si Kadri Cani, i cili në plejadën e intelektualëve të Dardhës e Dibrës të pas viteve '70, zë vend të veçantë, për vetë emrin e mirë që ka lënë në të gjithë sektorët ku ka punuar e drejtuar, ndërsa sot nuk gjen dot një punëtor për ta punësuar në kompleksin e tij bujqësoro-blegtoral.

Dhe jo vetëm, sipërmarrësit, por në këto kushte “kanë harru me qeshë” veçanërisht dhjetra mijëra të moshuarit e braktisur, në fshatra e qytete.

